KIPRED

INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE
KOSOVAR INSTITUTE FOR POLICY RESEARCH AND DEVELOPMENT

PUNIM I POLITIKAVE

Nr. 6/14 – DHJETOR 2014

# MARRËDHËNIET NDËRETNIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR: IMPLIKIMET PËR KOSOVËN

Ky projekt është përkrahur nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme

Përmbajtja dhe pikëpamjet të shprehura në këtë botim janë të KIPRED-it, dhe nuk mund të merren si pikëpamje të donatorit.

Përgatitur nga: Agon Demjaha dhe Lulzim Peci
Asistentë Hulumtues: Gent Gjikolli dhe Blerim Murtezi
Përkthimi: Mentor Agani

Copyright © 2014, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të reprodukohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 227 778.

Botuar nga:

Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave
Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A
10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778
www.kipred.org

## Përmbjatja

**Përmbledhje ekzekutive** ........ 4
**Rekomandime:** ........ 5
**1. Hyrje** ........ 6
**2. Shqipëria** ........ 8
**3. Bosnja e Hercegovina** ........ 13
**4. Kroacia** ........ 17
**5. Kosova** ........ 22
**6. Maqedonia** ........ 28
**7. Mali i Zi** ........ 32
**8. Serbia** ........ 36
**9. Përfundime dhe Rekomandime** ........ 42
**Rekomandime:** ........ 43
**Bibliografia** ........ 44

## Përmbledhje ekzekutive

Shpërbërja e dhunshme e ish-Jugosllavisë ka lënë trashëgimi mosbesime dhe armiqësi të thella midis etnive shumicë dhe pakicë në shtetet e reja që u shfaqën nga ajo. Përjashtim nga kjo rregull është Shqipëria, ku marrëdhëniet ndëretnike midis shumicës shqiptare dhe minoriteteve greke, maqedonase dhe të tjera, janë relativisht të mira.

Një çështje rënduese në të gjitha vendet e rajonit, pos Malit të Zi, janë mospajtimet rreth numrit të pjesëtarëve të komuniteteve minoritare që banojnë brenda këtyre shteteve. Një tipar shtesë i minoriteteve etnike është ai i kombësisë së padeklaruar në regjistrimet kombëtare. Po ashtu, këto shtete, me përjashtim të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, kanë kaluar nëpër ndryshime dramatike të përbërjes së strukturës së tyre etnike për shkak të luftrave dhe mizorive që janë shoqëruar me probleme të njerëzve që janë shndërruar në refugjatë dhe në të zhvendosur të brendshëm.

Pos kësaj, rrëfimet për pozitat e komuniteteve të minoriteteve etnike në shtetet e rajonit, pos në Shqipëri dhe Kroaci, deri në një masë janë ende të hapura. Kroatët dhe, posaçërisht, serbët, në Bosnje e Hercegovinë kanë ende ambicje separatiste, pavarësisht nga statusi i tyre i barabartë me boshnjakët dhe natyra federale e këtij shteti. Në Kosovë, komuniteti serb kërkon autonomi më të fuqishme territoriale, ndërkohë që ata që jetojnë në veriun e vendit janë tejet të prirur ndaj separatizmit dhe njësimit me Serbinë. Shqiptarët në Maqedoni janë të pakënaqur me pozitën e tyre, dhe janë duke kërkuar më tepër të drejta në nivelin kombëtar. Situata është pak a shumë e njëjtë me minoritetin etnik serb në Mal të Zi. Në Serbi, edhe boshnjakët në Sanxhak, edhe shqiptarët në Luginën e Preshevës janë duke kërkuar autonomi territoriale dhe janë të prirur ndaj separatizmit dhe njësimit me Bosnjen e Hercegovinën, përkatësisht Kosovën.

Marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërshtetërore në dhe midis vendeve të veçanta të Ballkanit Perëndimor janë përbërës të po të njëjtit ekuacion. Përmirësimet apo përkeqësimet e marrëdhënieve midis vendeve të veçanta të Ballkanit Perëndimor e kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet ndëretnike brenda këtyre shteteve. Pavarësisht nga marrëdhëniet e përmirësuara, mosbesimi ende mbizotëron në marrëdhëniet bilaterale midis vendeve fqinje në Ballkanin Perëndimor, kryesisht për shkak të frikës së shfrytëzimit të minoriteteve etnike nga vendet e tjera fqinje për qëllime separatiste apo destabilizuese.

## Rekomandime:

1. Qeveria e Kosovës duhet t'ia kushtojë vëmendjen e duhur situatës së marrëdhënieve ndëretnike në vendet fqinje dhe në Bosnje e Hercegovinë. Për këtë qëllim, në kuadrin e Drejtorisë për Çështjet Rajonale të Ministrisë së Punëve të Jashtmee duhet themeluar task-forcën për këtë çështje ashtu që kjo të ndiqet në mënyrë sistematike.

2. Të gjitha vendet në rajon, dhe posaçërisht Serbia në raport me Bosnjen e Hercegovinën dhe Kosovën, si dhe Kosova në raport me Luginën e Preshevës, duhet ta qartësojnë që ndryshimet e kufijve janë të papranueshëm.

3. UE-ja së bashku me OSBE-në dhe Këshillin e Evropës duhet ta ushtrojnë një trysni të posaçme në të gjitha vendet e rajonit për të organizuar regjistrime kredible, ashtu që t'i zgjidhin grindjet mbizotëruese rreth numrit të pjesëtarëve të komuniteteve etnike minoritare.

4. Unioni Evropian, OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës duhet ta fuqizojnë qasjen rajonale ndaj marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërshtetërore. Vëmendje e veçantë duhet t'i jipet Sanxhakut dhe Luginës së Preshevës që janë lënë anash fushës së marrëdhënieve ndërshtetërore midis Serbisë dhe Bosnjes e Hercegovinës, përkatësisht Serbisë dhe Kosovës.

5. OSBE-ja duhet ta merr parasysh mundësinë e hapjes së zyrave në Sanxhak dhe në Luginën e Preshevës ashtu që t'i përcjellë nga afër këto dy zona që praktikisht janë lënë pa mbrojtje.

# 1. Hyrje

Shpërbërja e ish-Jugosllavisë ka patur pasoja të mëdha për popujt që jetonin në territorin e këtij shteti. Pjesë shumë të mëdha të popullatave që e kanë gëzuar statusin e kombeve, përnjëherësh u shndërruan në minoritete kombëtare në shtetet që u shfaqën nga hiri i ish-Jugosllavisë, me përjashtim të shqiptarëve në Kosovë, statusi i të cilëve u ndryshua nga ai i minoritetit kombëtar në shumicë. Po ashtu, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova u bënë përjashtim nga rregulli krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, si vendet e vetme që nuk e kanë kombin titullar. Nga ana tjetër, tranzicioni nga komunizmi në demokraci në Shqipëri, po ashtu, mundësoi edhe njohjen e minoriteteve kombëtare.

Të gjitha vendet e rajonit, me përjashtim të Shqipërisë dhe Malit të Zi, kaluan nëpër luftra dhe konflikte të armatosura ndëretnike. Kësisoj, akomodimi i minoriteteve etnike në shtetet e reja u shndërrua në njërin nga tiparet vendimtare që e karakterizuan tranzicionin nga shoqëritë e dërrmuara nga luftrat në ato demokratike. Mirëpo, ky tranzicion ka patur trajta të ndryshme në vendet e rajonit. Bosnja e Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, dhe, pjesërisht, edhe Serbia, e kanë adresuar akomodimin e minoriteteve etnike me procese të negociatave të ndërmjetësuara nga bashkësia ndërkombëtare, ndërkohë që Shqipëria dhe Mali i Zi këtë e kanë bërë përmes reformave të brendshme, edhe pse, të shtyra nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare.

Sa i përket përfaqësimit të minoriteteve, Kroacia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia i kanë paraparë ulëset e garantuara në Parlamentet e tyre Kombëtare,[1] ndërkohë që vendet e tjera të rajonit nuk kanë paraparë një përfaqësim të tillë. Sidoqoftë, Kosova është vendi më i përparuar në rajon sa i përket përfaqësimit të grupeve etnike minoritare, duke i garantuar 20 nga 120 ulëset e veta për përfaqësuesit e tyre.

Duhet vërejtur që këto ndryshime kanë krijuar qendra mono-polare të serbizmit dhe kroatizmit, dhe një shqiptarizëm bipolar, me dy qendra. Megjithatë, është një dallim midis kroatizmit dhe shqiptarizmit, nga njëra anë, dhe serbizmit, nga tjetra. Kroacia, Shqipëria dhe Kosova e inkurajojnë integrimin e kroatëve dhe shqiptarëve në vendet ky ata banojnë, ndërsa Serbia nuk e bën këtë me serbët që jetojnë jashtë saj, dhe posaçërisht jo me ata që jetojnë në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë. Në këto dy vende Beogradi është duke nxitur politika jo-integruese, së bashku me përkufizimin normativ të territoreve ku minoriteti etnik serb paraqet shumicë.[2] Megjithatë, minoriteti

---

[1] Croatian Parliament; Constitutional Act Amending the Constitutional National Minority Rights Act. Class: 011-01/10-01/50, Reg. no.: 71-05-03/1-10-2, Zagreb, 18 June 2010.
The Constitution of the Republic of Kosovo; Chapter IV - Assembly of the Republic of Kosovo, Structure of Assembly. Article 64. Paragraph 2 and 3.
Parliament of Montenegro: Law on Minority Rights and Freedoms, Article 23
Law on Elections of members of Parliament; "Official Gazette of Republic of Srebia", no. 35/2000, 57/2003 – decision of CCRS, 72/2003 –oth.law, 75/2003 – correction of oth. law, 18/2004, 101/2005 – oth. law, 85/2005 – oth.law, 28/2011 – decision of CC and 36/2011". Article 81.
[2] Lulzim Peci, "Kosovo in the Security and Defense Context of the Western Balkans", KIPRED, September 2014, p.19

etnik më i pambrojtur nga shteti i vet amë në Ballkanin Perëndimor, janë boshnjakët, për shkak se vetë natyra e shtetit të Bosnjes e Hercegovinës e pamundëson Sarajevën nga luajtja e një roli të tillë.

Nga ana tjetër, zgjerimi i NATO-s në Ballkanin Perëndimor e ka një rol fundamental në mos-ndryshimin e kufijve shtetërorë të vendeve individuale të rajonit. Anëtarësimi në NATO i ka zbehur ambicjet e një pjese të elitave etnike shqiptare në Kosovë për bashkim me Shqipërinë, dhe të një pjese të elitave etnike kroate në Bosnje e Hercegovinë për bashkim me Kroacinë.[3] Mirëpo, rrethanat e mos-anëtarësimit në NATO dhe/ose në UE të Bosnjes e Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe të Serbisë, janë duke e mbajtur gjallë ende mundësinë e grindjeve dhe konflikteve ndëretnike midis Republikës Serbe dhe Federatës së Bosnjes e Hercegovinës, të Veriut të Kosovës, të zonave të populluara me serbë të Malit të Zi, të Maqedonisë Perëndimore, të Sanxhakut dhe të Luginës së Preshevës.

Ky punim i heton problemet e marrëdhënieve ndëretnike në vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe përfshin prapavijën, përbërjen etnike, të drejtat dhe përfaqësimin politik. Në një numër vendesh grindjet kanë të bëjnë me numrin e pjesëtarëve të minoriteteve etnike, ndërkohë që në të tjerat, këto kanë të bëjnë me kërkesat për më tepër të drejta minoritare etnike, përfshirë këtu edhe autonominë territoriale.

[3] Ibid, p.73

## 2. Shqipëria

Pas shembjes së komunizmit, Shqipëria doli si vendi më i izoluar dhe më i varfër i Evropës. Regjimi tejet mizor komunist në Shqipëri shtypi çdo formë të mospajtimit politik, të përkushtimit fetar dhe të aktivitetit të pavarur qytetar. Të drejtat dhe liritë njerëzore të të gjitha grupeve etnike, si të minoriteteve, ashtu edhe të shumicës, gjatë kësaj periudhe janë shkelur me të madhe. Pos kësaj, forcat fetare dhe etnike janë dobësuar nga ideologjia komuniste, që identitetit shoqëror i jipte parësi ndaj identiteteve primordiale.[4] Si pasojë, gjatë periudhës komuniste, Shqipëria nga jashtë përgjithësisht shihej si një shtet etnikisht homogjen. Mirëpo, kjo vazhdimisht është vënë në pyetje nga minoritetet e ndryshme etnike përbrenda Shqipërisë, si dhe nga disa nga shtetet fqinje. Pohimet e tilla janë intensifikuar edhe më tepër pas fundit të sundimit komunist dhe demokratizimit të Shqipërisë. Rrjedhimisht, mospajtimi kryesor ndëretnik në Shqipëri është në fakt ai për madhësinë e minoriteteve të ndryshme që jetojnë në vend.

Aktualisht, Shqipëria si minoritete kombëtare i njeh grekët, maqedonasit, malazezët dhe serbët, ndërkaq, vllehët/arumunët dhe romët njihen vetëm si minoritete linguistike/kulturore. Si minoritetet kombëtare, ashtu edhe ato linguistike, janë të njohura sipas traktatit multilateral të Këshillit të Evropës – Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (KKMK) – që Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 1999.[5] Në Shqipërinë e sotme, minoriteti grek, pos që është minoriteti më i madh etnik, është, po ashtu, i vetmi që është mjaft i madh për ta patur një rëndësi të mjaftueshme politike, ekonomike dhe shoqërore. Debati për madhësinë e tij aktuale është posaçërisht kundërshtues, meqë ky në një mënyrë të pazgjidhshme është i lidhur me pretendimet territoriale historike ndaj Shqipërisë Jugore nga grupe të ndryshme nacionaliste greke dhe nga përfaqësues shtetërorë, që pretendojnë që një pjesë e Shqipërisë Jugore – që për grekët është e njohur si Epiri Verior – historikisht i takon Greqisë.[6] Rëndësia politike e minoritetit grek shumëfishohet më tutje nga afërsia e shtetit grek që i ushqen lidhjet e afërta ekonomike dhe kulturore me minoritetin e vet.[7] Minoriteti grek përfaqësohet nga Unioni Demokratik i Minoritetit Grek, OMONIA, dhe nga partia politike Partia e Unionit të të Drejtave Njerëzore (PUDNJ). PUDNJ është themeluar në shkurt 1992, pas miratimit të legjislacionit për ndalimin e partive të bazuara mbi "parimet etnike." Partia u bë trashëgimtare elektorale e OMONIA-s, duke i fituar dy ulëse në Kuvend në marsin 1992, përkundrejt pesë ulëseve të OMONIA-s në vitin 1991.[8]

Përndryshe, përkushtimi i Shqipërisë ndaj mbrojtjes së minoriteteve filloi pas Luftës së Parë Botërore, me hyrjen e saj në Lidhjen e Kombeve në dhjetor 1920. Prandaj, që nga viti 1921,

---

[4] Barjarba, Kosta, "Migration and Ethnicity in Albania: Synergies and Interdependencies," *Brown Journal of World Affairs*, Vol. XI, Issue 1, Verë/Vjeshtë 2004, fq. 233.
[5] "World Directory of Minorities and Indigenous Peoples – Albania," Minority Rights Group International, 2007; http://www.refworld.org/docid/4954cdfe1a.html (04.11.2014).
[6] Vickers, Miranda, "The Greek Minority in Albania – Current Tensions," *Balkan Series* 10/02, Defence Academy of the United Kingdom, 2010, fq. 2.
[7] *Ibid.*
[8] Barjarba, 2004, fq. 235.

popullata etnike greke e Shqipërisë është regjistruar si minoritet që jetonte në "zonat e njohura të minoriteteve."[9] Sipas hetimit të bërë nga Lidhja e Kombeve në vitin 1922, në Shqipëri ishin rreth 25,000 njerëz që flisnin greqisht. Megjithatë, meqë studimi është bërë vetëm në pjesë të kufizuara të kufirit jugor, ka arsye të fuqishme për të besuar që vlerësimi ishte tepër i ulët.[10] Pas Luftës së Dytë Botërore, regjimi i ri komunist i Shqipërisë e ngushtoi hapësirën e Shqipërisë Jugore të përshkruar si "zonë e minoritetit" në vetëm 99 fshatra në qarqet e Gjirokastrës dhe të Sarandës, pa i përfshirë tre fshatrat e Himarës, Drimadës dhe Palasesë, që ishin njohur si hapësira minoritetesh nga Lidhja e Kombeve në vitin 1921.[11] Një përcaktim i tillë i përjashtonte, po ashtu, minoritetet etnike që jetonin gjetkë anembanë vendit. Fshatrat e përziera jashtë zonave të përcaktuara, madje edhe ato kishin një shumicë të pastër të ndonjë minoriteti etnik, nuk konsideroheshin si hapësira minoritetesh, dhe për këtë arsye, atyre iu mohuan çfarëdo dispozitash gjuhësore, kulturore apo edukative.[12] Pos kësaj, si pjesë e politikës komuniste të popullatës, për t'i parandaluar burimet etnike të mospajtimit politik, shumë grekë u zhvendosën me forcë nga zonat e minoritetit në pjesë të tjera të vendit. Për më tepër, gjatë regjimit komunist, toponimet greke u ndryshuan në asi shqiptare, dhe shfrytëzimi i gjuhës greke ishte i kufizuar vetëm brenda zonave të minoritetit.[13]

Sipas regjistrimit të fundit në Shqipëri gjatë sundimit komunist që u bë në vitin 1989, në vend jetonin 58,758, apo 1.8 përqind të grekëve etnikë. Mirëpo, këta numra zyrtarë u mohuan fuqishëm, si nga komuniteti grek, ashtu edhe nga autoritetet greke. Udhëheqësit e komunitetit etnik grek pohojnë që numri i tyre është rreth 260,000, me disa vlerësime që shkojnë deri në 400,000. Sipas Komitetit Grek të Helsinkit, numri është rreth 150,000, ndërsa The #orld Fact Book i CIA-s i vitit 1994 minoritetin grek e vlerëson në 3 përqind të popullatës, apo në rreth 100,000 veta.[14] Regjistrimi i parë pas rënies së komunizmit, i mbajtur në vitin 2001 nuk e kishte pyetjen lidhur me origjinën etnike apo fetare. Si pasojë, kreu i Unionit Demokratik të Minoritetit Grek, OMONIA, i akuzoi autoritetet shqiptare që po përpiqeshin ta bojkotojnë regjistrimin.[15] Pas disa rekomandimesh nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Jotolerancës (KERJ), qeveria shqiptare në fund vendosi ta bëjë një regjistrim të përgjithshëm në të tërë vendin që do ta përfshinte pyetjen që kishte të bënte me identitetin etnik.[16] Mirëpo, autoritetet shqiptare bënë amandamentime në çastin e fundit, duke futur gjoba për përgjigje të gabuara në pyetësor. Sipas këtyre ndryshimeve, përgjigja do të konsiderohej e gabuar nëse nuk do të përputhej me të dhënat që përmbaheshin në regjistrin civil.[17] Hapat e tillë përsëri u kritikuan

---

[9] "Zonat e minoriteteve" janë qarqe të veçanta (Gjirokastra, Saranda dhe Delvina, për personat që i takojnë minoritetit grek, dhe qarku i Korçës (komuna e Liqenasit) dhe e Delvinës (komuna e Vernikut) për personat që i takojnë minoritetit maqedonas), të kategorizuara si të tilla nën regjimin komunist, të banuara nga numra përmbajtësorë që i takojnë minoriteteve kombëtare; shih "Third Opinion on Albania," 2011, fq. 11.
[10] Pettifier, James, "The Greek Minority in Albania in the Aftermath of Communism," Conflict Studies Research Centre, korrik 2001, fq. 6.
[11] Vickers, 2010, fq. 3.
[12] "Albania: The Greek Minority," *Human Rights Watch/Helsinki*, Vol. 7, No. 4, 2 shkurt 1995, fq. 6.
[13] Pettifier, 2001, fq. 7.
[14] Human Rights Watch/Helsinki, 1995, fq. 6.
[15] "Albania: State of the Nation," International Crisis Group, Balkans Report N°111, 25 maj 2001, fq. 12.
[16] Shih "Third report on Albania," European Commission against Racism and Intolerance, 17 dhjetor 2004.
[17] "Third Opinion on Albania," ACFC/OP/III(2011)009, Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, 23 nëntor 2011.

fuqishëm nga OMONIA dhe nga partitë opozitare greke, që, po ashtu, thirrën për bojkotimin e regjistrimit.[18] Sipas rezultateve zyrtare, minoritetet etnike në Shqipëri u tkurrën në numër, ku numri i qytetarëve të etnisë greke ishte vetëm 0.87 përqind e popullatës. Minoriteti grek reagoi furishëm, ku OMONIA refuzoi t'i pranonte rezultatet e regjistrimit dhe pohonte që këto rezultate ishin falsifikuar në dëm të grekëve etnikë dhe të minoriteteve të tjera ortodokse.[19] Komiteti Këshillues i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare po ashtu "konsideron që rezultatet e regjistrimit duhet të shikohen me kujdesin më të madh dhe i thërret autoritetet që të mos mbështeteshin ekskluzivisht në të dhënat për kombësinë të grumbulluara në regjistrim në përcaktimin e politikës së vet për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare."[20] Sidoqoftë, duhet të përmendet që e tërë popullata e Shqipërisë ka rënë po ashtu për afërsisht 8 përqind që nga viti 2001, dhe që numrat aktual janë posaçërisht të vështirë për t'u përcaktuar për shkak të migrimit tepër të madh të shqiptarëve dhe të minoriteteve etnike që nga viti 1991.[21] Nga ana tjetër, një numër i konsiderueshëm i popullatës së minoritetit grek lëvizi në Greqi ku e gëzon një status shumë të privilegjuar. Ata marrin vizat shumë të çmuara greke, banesa dhe leje pune, dhe kanë privilegje sa i përket punësimit, shkollimit të fëmijëve të tyre dhe trajtimit mjekësor.[22]

Pos mospajtimit për madhësinë, marrëdhëniet midis minoritetit grek dhe shumicës shqiptare për një kohë mjaft të gjatë janë trajtësuar nga pretendimet territoriale ndaj pjesës jugore të Shqipërisë. Gjatë komunizmit, politikat e autoriteteve shqiptare kanë qenë të përpiluara për ta penguar mbajtjen apo rritjen e ndonjë identiteti të veçantë grek brenda Shqipërisë, dhe këto kanë qenë të ndikuara në një mënyrë domethënëse nga pretendimet zyrtare iredentiste të Greqisë.[23] Gjatë viteve fillestare pas komunizmit, marrëdhëniet midis Greqisë dhe Shqipërisë ishin të ftohta, dhe, kohë pas kohe, edhe të ngrira, ndërkohë që minoriteti etnik grek shpesh herë trajtohej si peng nga dy fqinjët grindavecë.[24] Armiqësitë midis dy vendeve e arritën kulmin e vet në vitin 1995, kur pesë aktivistë të Omonias u arrestuan dhe u burgosën, nën akuzën e bashkëpunimit me shërbimin sekret grek kundër integritetit dhe sovranitetit të Shqipërisë.[25] Megjithatë, pas trazirave në vitin 1997, dhe ndryshimit të mëpastajmë të qeverisë, marrëdhëniet dalëngadalë u normalizuan.

Aktualisht, çështja kryesore lidhur me minoritetin grek ka të bëjë me të drejtat politike, njerëzore, edukative dhe kulturore të komunitetit grek në Shqipëri. Sot, si rezultat i përvetësimit të legjislacionit

---

[18] Krasniqi, Gezim, "The Politics of Numbers and Identity in Albania," *Citizenship in Southeast Europe*, 14 mars 2012; http://www.citsee.eu/blog/politics-numbers-and-identity-albania (10.11.2014).

[19] "Final census findings lead to concerns over accuracy," *Tirana Times*, 19 dhjetor 2011; http://www.tiranatimes.com/news.php?id=14605&cat=1 (10.11.2014).

[20] "Third Opinion on Albania," 2011, fq. 6.

[21] Sipas Ministrisë shqiptare te Punës dhe Çështjeve Sociale, në vitin 1999 ishin më shumë se 800,000 emigrantë shqiptarë, ku 500,000 ishin në Greqi dhe 200,000 në Itali; shih King, Russell dhe Vullnetari, Julie, "Migration and Development in Albania," *Sussex Centre for Migration Research*, dhjetor 2003, fq. 25. Nga ana tjetër, sipas Vickers, që nga fundi i shtetit njëpartiak në vitin 1991, deri në dy të tretat e popullatës së minoritetit grek kishte shkuar të jetonte në Greqi; shih Vickers, 2010, fq. 1.

[22] Vickers, 2010, fq. 10.

[23] Pettifier, 2001, fq. 8.

[24] Posaçërisht gjatë presidencës së Sali Berishës (1992-1997); shih Vickers, 2010, fq. 3.

[25] Barjarba, 2004, fq. 235.

që i përmirëson të drejtat e minoritetit grek, mund të thuhet që shumica e nevojave kulturore dhe edukative të minoriteteve janë adresuar. Shqipëria ka bërë, po ashtu, përmirësime në përfaqësimin politik të minoriteteve, duke siguruar, kësisoj, që këto të jenë të përfaqësuara në mënyrë adekuate, të paktën në nivelin lokal, nëse jo edhe në atë kombëtar. Fakti që minoriteti etnik grek merr pjesë lirshëm në politikën shqiptare tregon që grupi vështirë se mund të përjetojë çfarëdo disavantazhesh për shkak të ndonjë diskriminimi të paramenduar grupor.[26] Sidoqoftë, janë disa ankesa nga minoriteti grek "për mosgatishmërinë e qeverisë për t'i njohur qytetet greke jashtë "zonave të minoriteteve" të epokës së komunizmmit, për ta shfrytëzuar greqishten në dokumentet zyrtare dhe në shenjat publike në hapësirat etnike greke, si dhe për ta përfshirë një numër më të madh të grekëve etnikë në administratën publike."[27] Megjithatë, është bindje jona që marrëdhëniet e ardhshme midis shumicës shqiptare dhe minoritetit grek do të varen në masë të madhe nga marrëdhëniet e tërësishme midis Shqipërisë dhe Greqisë. Përmirësimi i kohëve të fundit i këtyre marrëdhënieve bilaterale, padyshim që do t'i kontribuojë relaksimit të marrëdhënieve të tërësishme midis dy etnive. Nga ana tjetër, marrëdhëniet e mira dhe stabile midis anëtarëve të dy grupeve etnike në Shqipëri mund të shërbejnë si një garancë për marrëdhëne të mira fqinjësore të përhershme midis dy vendeve.

Minoritetet e tjera në Shqipëri i kanë mohuar po ashtu shifrat zyrtare lidhur me madhësinë e tyre në vend, dhe posaçërisht minoriteti etnik maqedonas. Maqedonasve etnikë u është dhënë statusi i minoritetit pas Luftës së Dytë Botërore, kur është krijuar Republika e Maqedonisë në kuadrin e Jugosllavisë socialiste. Minoriteti kombëtar maqedonas është i përqendruar në hapësirën e Prespës, që është 30 km në verilindje të qarkut të Korçës. Kjo hapësirë shtrihet në skajin juglindor të Shqipërisë, në kufi me Republikën e Maqedonisë dhe me Greqinë. Minoriteti maqedonas jeton në një trajtë kompakte në një mjedis rural, mirëpo ka po ashtu banorë të kësaj etnie që banojnë në qytetet e Korçës, të Pogradecit dhe të Tiranës. Megjithatë, ngjashëm me minoritetin grek, Shqipëria i njeh të drejtat minoritare vetëm brenda "zonave të minoriteteve."[28] Sipas regjistrimit të fundit komunist në vitin 1989, numri i tyre ishte 4,700. Ngjashëm me minoritetin grek, udhëheqësit e minoritetit maqedonas e kanë bojkotuar regjistrimin e vitit 2001 dhe kanë thirrur po ashtu për bojkotimin e regjistrimit në vitin 2011 për shkak të amandamentimeve të çastit të fundit. Edhe pse sipas rezultateve zyrtare ata e përbëjnë vetëm 0.2 përqind (5,512) të popullatës së tërësishme të vendit,[29] maqedonasit etnikë (dhe shpesh herë, edhe përfaqësues të caktuar të Republikës së Maqedonisë) kanë spekuluar me shifra shumë më të larta.[30] Mirëpo, duket që këta numra të ekzagjeruar paraqesin më tepër një prirje për ta krijuar një paralele të caktuar me minoritetin shumë

---

[26] Vickers, 2010, fq.9.

[27] "Country Report on Human Rights Practices 2013: Albania," United States Department of State (USSD), 27 shkurt 2014 http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/index.htm?year= 2013&dlid=220247 (11.11.2014).

[28] Për më shumë hollësi lidhur me minoritetin maqedonas, shih Minority Rights Group International, *World Directory of Minorities and Indigenous Peoples - Albania: Macedonians*, 2008; http://www.refworld.org/ docid/49749d65b.html (15.11.2014).

[29] "Population and Houses Census," Instituti i Statistikave, Republika e Shipërisë, 2011, http://www.instat.gov.al/media/178070/rezultatet_kryesore_t__censusit_t__popullsis__dhe_banesave_2011_n__shqip_ri.pdf (17.11.2014).

[30] Për shembull, në vitin 2003, Asociacion i Maqedonasve në Shqipëri e bëri regjistrimin e vet të numrit të maqedonasve në Shqipëri. Ky e vlerësoi një popullatë midis 12,000 dhe 35,000; shih *World Directory of Minorities and Indigenous Peoples - Albania: Macedonians*, 2008.

të madh shqiptar në Maqedoni, sesa ndonjë realitet faktik. Pos madhësisë së tij, çështjet kryesore lidhur me minoritetin maqedonas në Shqipëri kanë të bëjnë me të drejtat e tyre politike, edukative dhe kulturore. Sa i përket edukimit, mësimdhënie në maqedonisht ka patur brenda zonës së minoritetit që nga viti 1945, dhe atë në arsimin fillor deri në klasën e pestë, dhe për të tekstet shkollore janë botuar nga shteti. Kërkesa kryesore e minoriteti maqedonas është që e drejta e mësimdhënies në gjuhën e tyre amtare për nxënësit e përkatësisë etnike maqedonase të zgjerohet në pajtim me standardet ndërkombëtare edhe në pjesët e tjera të Shqipërisë. Bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit në fushën e edukimit të nënshkruara me Maqedoninë, ka shpresa që mësimdhënia në gjuhën maqedonase do të hyjë edhe në edukimin sekondar.[31]

Ashtu siç u përmend më heret, minoritetet e tjera të njohura në Shqipëri përfshijnë vllehët/arumunët dhe romët, që e kanë vetëm statusin e minoriteteve linguistike/kulturore. Çështja kryesore lidhur me këto dy minoritete ka të bëjë me kërkesën e tyre për t'u trajtuar si minoritete kombëtare, dhe jo vetëm linguistike.[32] Nga ana tjetër, edhe më problematike është çështja e egjiptasve dhe boshnjakëve meqë këta nuk janë të njohur as si minoritet kombëtar, as si linguistik, edhe përkundrejt kërkesës së tyre që të njihen si persona që i takojnë një minoriteti kombëtar. Edhe pse një njohje e tillë do t'u mundësonte këtyre dy grupeve të përftojnë nga mbrojtja e Konventës Kornizë, kërkesat e tyre nuk janë marrë parasysh nga autoritetet shqiptare dhe ekzistenca e tyre si grupe të dallueshme me identitete të veçanta nuk është pranuar.[33] Sidoqoftë, duhet të vërehet që, në përgjithësi, në Shqipëri mbizotëron një klimë e respektimit dhe tolerancës midis minoriteteve kombëtare dhe popullatës shumicë. Sa i përket respektimit të minoriteteve dhe mbrojtjes së tyre, marrëdhëniet ndëretnike janë, po ashtu, përgjithësisht të mira.[34] Çështja më e ngutshme mbetet një regjistrim gjithështetëror i popullatës që do të ofronte të dhëna të sigurta për numrin e personave që u takojnë minoriteteve kombëtare në pajtim me parimet e vetëidentifikimit të lirë dhe të grumbullimit të të dhënave të njohura ndërkombëtarisht dhe në pajtim me standardet e mbrojtjes së minoriteteve.[35] Edhe pse regjistrimi i fundit i vitit 2011 përmbante për herë të parë që nga rënia e komunizmit pyetjet për origjinën etnike, ky nuk ia doli të jipte të dhëna të besueshme lidhur me numrin e minoriteteve në vend. Pos që është vënë në dyshim nga përfaqësuesit e pothuaj të gjitha minoriteteve, fakti që 14 përqind të popullatës refuzoi t'i përgjigjej pyetjes për origjinën etnike është mjaft brengosës. Një ambiguitet i tillë lidhur me numrat e minoriteteve lë hapësirë për spekulime, si nga përfaqësuesit e minoriteteve në Shqipëri, ashtu edhe nga qeveritë e disave nga vendet fqinje. Kjo, më tutje, vetëm i ngarkon marrëdhëniet ndëretnike në vend dhe i tendos pa nevojë marrëdhëniet e Shqipërisë me fqinjët e vet.

---

[31] *Ibid.*

[32] "World Directory of Minorities and Indigenous Peoples – Albania," 2007.

[33] "Third Opinion on Albania," 2011, fq. 10.

[34] "Albania: Minority ethnic groups," Country Information and Guidance, Home Office United Kingdom, 14 nëntor 2014, fq. 15.

[35] "Third Opinion on Albania," 2011, fq. 34.

## 3. Bosnja e Hercegovina

Bosnja e Hercegovina (BeH) është përshkruar shpesh herë si "Jugosllavi në miniaturë," meqë kjo ishte republika më multietnike dhe multifetare në ish-Jugosllavi. Për shekuj me radhë, tre grupet kryesore etnike – myslimanët e Bosnjes (apo boshnjakët), kroatët katolikë dhe serbët ortodoksë, jetuan në mënyrë paqësore njëri pranë tjetrit.[36] Rrjedhimisht, Bosnja e Hercegovina është parë gjerësisht si një vend-përzierje e Jugosllavisë, me numrin më të lartë të martesave etnikisht të përziera dhe me marrëdhënie të tërësishme harmonike ndëretnike. Mirëpo, menjëherë pas shpalljes së saj të pavarësisë, BeH u dërrmua nga lufta më shkatërrimtare (prill 1992 – dhjetor 1995) e Evropës që nga Lufta e Dytë Botërore, në të cilën u vranë rreth 200,000 njerëz.[37] Lufta u karakterizua me një nacionalizëm të skajshëm, me dhunë dhe spastrim etnik, dhe me përpjekje të shumta nga të gjitha palët për ta ndarë BeH territorialisht përgjatë vijave etnike. Ndërkohë që Marrëveshja e Dejtonit në vitin 1995 e ndali gjakderdhjen, kjo në thelb edhe e përligji spastrimin etnik dhe kufijtë e krijuar përmes dhunës së armatosur. Dhe, më e rëndësishmja, kjo nuk solli stabilitet dhe zhvillim afatgjatë të vendit.

Marrëveshja e Dejtonit u përpilua për t'i ndarë entitetet në Bosnje e Hercegovinë: Federatën Boshnjako-Kroate të Bosnjes e Hercegovinës, me 51 përqind të territorit, dhe Republikën Serbe të Bosnjes, apo Republikën Serbe (RS), me 49 përqind të territorit, çdonjëra me presidentin, qeverinë, parlamentin, policinë dhe trupat e tjerë të vet. Mirëpo, kjo, po ashtu, atë e përcaktoi si një shtet të tërë, si i kundërt me konfederatën, pa patur ndonjë entitet apo entitete me të drejtë për t'u shkëputur nga BeH, përpos përmes procesit legal. Edhe pse tejet e decentralizuar në entitetet e veta, BeH e ruajti qeverinë qendrore, me një Presidencë Shtetërore rotative, me një bankë qendrore dhe me një gjykatë kushtetuese. Pos kësaj, Federata e Bosnjes e Hercegovinës ishte e ndarë në 10 kantone që shërbejnë si njësi të nivelit të dytë të autonomisë lokale dhe njësitë federale të Federatës së Bosnjes e Hercegovinës. Nga ana tjetër, Republika Serbe e ka një qeveri të centralizuar dhe është e ndarë drejtpërdrejtë në 63 komuna. Përfundimisht, Qarku i Brqkos, që është etnikisht i shumëllojshëm e paraqet një rast të veçantë dhe që nga viti 1999 është i vendosur nën jurisdiksionin e Bosnjes e Hercegovinës. Pos kësaj, marrëveshja mandatonte një brez të gjerë të organizatave ndërkombëtare për t'i monitoruar, mbikëqyrur, dhe zbatuar komponentet e marrëveshjes, nga të cilat Zyra e Përfaqësuesit të Lartë (ZPL) është e ngarkuar me detyrën e implementimit civil.[38] Një sistem i

[36] Marko, Joseph, "Bosnia and Herzegovina - Multi-Ethnic or Multinational?," në Council of Europe (red.), *Societies in Conflict: The contribution of law and democracy to conflict resolution*, Science and Technique of Democracy No. 29, Strasbourg 2000, fq. 92.

[37] Ka vlerësime shumë të ndryshme lidhur me numrin e viktimave. Edhe pse Tribunali Kriminal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY) punon me shifrën pre 102,622 të vrarë, Qeveria e Bosnjes dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) kanë vlerësuar që numri i viktimave të drejtpërdrejta dhe indirekte mund të jetë deri në 200,000 njerëz; shih Kivimäki, Timo, Kramer, Marina and Pasch, Paul, "The Dynamics of Conflict in the Multi-ethnic State of Bosnia and Herzegovina," *Country Conflict-Analysis Study*, Sarajevo: Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), mars 2012, fq. 14.

[38] Që nga viti 1997, OHR-së i janë dhënë fuqi shtesë për të marrë vendime detyruese kur palët lokale janë të paafta apo jo të gatshme për të vepruar, si dhe për t'i larguar nga pozita zyrtarët publikë që i shkelin përkushtimet legale të Marrëveshjes së Dejtonit; shih "The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina," 21 nëntor 1995; http://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/BA_951121_ DaytonAgreement.pdf (20.12.2014).

elaboruar në një mënyrë të tillë, me shumë rreshta qeverisës, me kabinete dhe parlamente në nivelet shtetërore, të entiteteve dhe në ato kantonale, vendin e shkatërruar dhe të varfëruar nga lufta e dënoi me një strukturë të tejngarkuar të politikanëve dhe të shërbyesve civilë.

Ashtu si para dhe gjatë luftës, marrëdhëniet e tashme ndëretnike në Bosnje e Hercegovinë janë të përcaktuara nga marrëdhëniet e tërësishme midis tre grupeve përbërëse etnike (kombeve) – boshnjakëve, serbëve dhe kroatëve. Megjithatë, tradita e gjatë e bashkekzistencës paqësore tash është zëvendësuar me një mosbesim të ndërsjellë dhe me paragjykime të fuqishme kundër "të tjerëve." Spastrimi etnik gjatë luftës, po ashtu, e ka ndryshuar demografinë e vendit në një mënyrë dramatike. Para luftës, boshnjakët paraqisnin 44 përqind, serbët 31 përqind, dhe kroatët 17 përqind, të popullatës së tërë të vendit.[39] Pos personave të vrarë dhe të zhvendosur, lufta në BeH rezultoi në atë që mbi gjysma e popullatës së paraluftës prej 4,365,574 vetash, u zhvendos nga vendbanimet e tyre. Nga këta, më tepër se një milion u shndërruan në refugjatë, ndërkohë që një milion shtesë vlerësohet të kenë mbetur të zhvendosur të brendshëm brenda vendit. Më e rëndësishmja, spastrimi etnik e ka ndryshuar në një mënyrë domethënëse konfigurimin etnik në pjesën më të madhe të vendit, dhe deri në vitin 1995 ish territori i Bosnjes e Hercegovinës u shndërrua në një mozaik të hapësirave të reja etnikisht të spastruara.[40] Strukturat etnike të dy entiteteve kanë ndryshuar në një masë të konsiderueshme, dhe sot, edhe Federata e BeH, edhe Republika Serbe, mund të shihen si pothuaj etnikisht homogjene. Për shembull, ndërkohë që në vitin 1991 boshnjakët dhe kroatët e përbënin 28.77 përqind, përkatësisht 9.99 përqind, të popullatës së territorit të RS, në vitin 1997 këto paraqisnin vetëm 2.19 përqind dhe 1.02 përqind. Nga ana tjetër, përqindja e serbëve kërceu nga 54.3 përqind në 96.79 përqind të popullatës së vlerësuar prej 1,437,000 vetash të Republikës Serbe.[41] Ngjashëm, sipas regjistrimit të vitit 1991, Federata kishte 52.3 përqind boshnjakë, 21.9 përqind kroatë, 17.6 përqind serbë, 5.9 përqind jugosllavë dhe 2.3 përqind "të tjerë." Sipas vlerësimeve të vitit 2010, boshnjakët paraqesin rreth 70 përqind, kroatët rreth 25 përqind dhe serbët vetëm 1-2 përqind, të popullatës së Federatës.[42]

Si pasojë, që të tre grupet etnike përbërëse e kanë gjetur veten në një situatë mjaft të veçantë duke qenë shumicë etnike në disa pjesë të vendit dhe minoritet etnik në disa pjesë të tjera. Domethënë, edhe pse preambula e Kushtetutës së Dejtonit boshnjakët, kroatët dhe serbët i përcakton si popuj shtetformues në BeH, Kushtetutat e Entiteteve i kanë reduktuar zgjedhësit në nivelin e entiteteve. Prandaj, anëtarët e tre grupeve kryesore etnike e gëzojnë statusin e shumicës brenda entitetit të vet, mirëpo këto të drejta kushtetuese u mohohen në entitetin tjetër, meqë në të trajtohen si minoritet. Pra, boshnjakët dhe kroatët që jetojnë në Republikën Serbe, si dhe serbët që jetojnë në Federatë, edhe përkundrejt statusit të tyre shtetformues në nivelin e vendit, jetojnë në rrethana më të këqija se ato të minoriteteve tradicionale, meqë atyre u mungon çfarëdo qoftë mbrojtje kushtetuese apo

---

[39] Këto janë shifrat që bazohen në regjistrimin e vitit 1991; shih Kivimäki me të tjerë, 2012, fq. 14.
[40] Gearóid Ó Tuathail dhe John O'Loughlin "After Ethnic Cleansing: Return Outcomes in Bosnia-Herzegovina a Decade Beyond War," Annals of the Association of American Geographers, Vol.99, Issue 5, 2009, fq. 1047.
[41] "Bosnia: What does Republika Srpska want?," International Crisis Group, Europe Report N°214, 6 tetor 2011, fq. 1.
[42] "Federation of Bosnia and Herzegovina – A Parallel Crisis," International Crisis Group, Europe Report N°209, 28 tetor 2010, fq. 1.

ligjore. Edhe pse pabarazia kushtetuese dhe ligjore është eliminuar përmes vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që statusin shtetformues e zgjeruan në të tërë vendin, implikimet praktike të një realiteti të tillë vazhduan të ekzistojnë. Rrjedhimisht, çdonjëri nga tre grupet etnike shtetformuese është përballur me një diskriminim të dukshëm në territoret ku ata ishin pakicë.[43]

Aktualisht, përbërja e tërësishme e popullatës në BeH është ende e paqartë. Edhe pse regjistrimi i parë në vend pas luftës u bë në tetor 2013, rezultatet e plota zyrtare nuk janë dhënë ende. Megjithatë, të dhënat preliminare të botuara në nëntor 2013 kanë treguar që popullata e tërë është zvogëluar nga 4,377,033 në vitin 1991, në 3,791,662 në vitin 2013. Nga ana tjetër, gazeta ditore e Sarajevës "Dnevni Avaz" i ka botuar në janarin e vitit 2014 rezultatet jozyrtare preliminare për përbërjen etnike – 48.4 përqind boshnjakë, 32,7 përqind serbë, dhe 14.6 përqind kroatë.[44] Në kohën që priteshin rezultatet zyrtare, vetë regjistrimi tashmë ka hapur rrugë për spekulime të shumta dhe për debatime të nxehta. Është e qartë që politikanët e tre grupeve kryesore etnike ishin më të interesuar për t'i konfirmuar klasifikimet ekzistuese trepalëshe etno-nacionale, se për të përvetësuar çfarëdo ideje të përgjegjësisë për të gjithë qytetarët. Rrjedhimisht, regjistrimi u kthye në një debat për luftën dhe spastrimin etnik, për kontrollimin e territoreve të caktuara, dhe për ndryshimet eventuale demografike.[45] Marrë në tërësi, në vend se ta ofronte një themel për politikat e të ardhmes së përbashkët në vend, regjistrimi u kthye në një lojë tejet kontraverse të numrave që mund ta trazojë sistemin ekzistues të ndarjes së pushtetit të bazuar në kuota midis boshnjakëve, serbëve dhe kroatëve që para kësaj ishin duke luftuar.[46]

Prandaj, edhe pse lufta përfundoi pothuaj dy dekada më parë, marrëdhëniet ndëretnike në Bosnjën e kohës moderne ende mbeten mjaft problematike. Ngjashëm si edhe gjatë luftës, konflikti kryesor në parim është për territor. Statusi i territorit të BeH ishte i diskutueshëm në pjesën më të madhe të shekujve 19 dhe 20, që nga koha e "Çështjes Lindore," e deri në fundin e Luftës së Dytë Botërore.[47] Ashtu siç u përmend më heret, gjatë luftës 1992-1995, edhe serbët, edhe kroatët, synonin të krijonin entitete të veçanta territoriale që në fund do t'u bashkangjiteshin "atdheve" të tyre përkatës. Plane të tilla janë inkurajuar dhe përkrahur haptas nga Millosheviqi dhe Tugjmani që duket sikur ishin pajtuar për ndarjen e Bosnjes e Hercegovinës midis Serbisë dhe Kroacisë. Boshnjakët ishin të vetmit që nuk e kishin përkrahur ndarjen e vendit, dhe që luftuan për BeH si për atdheun e tyre.[48] Madje edhe sot,

---

[43] Kukić, Slavo, "Položaj nacionalnih i vjerskih manjina u Bosni i Hercegovini," Politička Misao, Vol. 38, br. 3, 2001, fq. 123.

[44] Kjo donte të thoshte që vendi i ka 585,411 qytetarë më pak se në regjistrimin e vitit 1991, dhe këta janë të shpërndarë si vijon: 62,55% në Federatë, 35 % në Republikën Serbe dhe 2,45 % në Brqko; shih "Bosnia Census in 2013," European Parliamentary Research Service, 27 janar 2014; http://epthinktank.eu/2014/01/27/bosnia-2013-census/ (21.12.2014).

[45] Rachel Irwin, Dzenana Halimovic, Maja Bjelajac, Dražen Huterer and Mladen Lakić, "Bosnian Census Risks Deepening Ethnic Rifts," *Institute for War & Peace Reporting*, 6 dhjetor 2013; https://iwpr.net/global-voices/bosnian-census-risks-deepening-ethnic-rifts (21.12.2014).

[46] Hopkins, Valerie "Bosnia census results threaten power-sharing system," *Global Post*, 13 nëntor 2013; http://www.globalpost.com/dispatch/news/regions/europe/131113/bosnia-census-results-threaten-power-sharing-system (21.12.2014).

[47] Burg, Steven, dhe Shoup, Paul, *The War in Bosnia-Herzegovina: Ethnic Conflict and International Intervention*, New York: M. E. Sharpe, 1999, fq. 17.

[48] Kivimäki me të tjerë, 2012, fq. 15-16.

serbët dhe kroatët e Bosnjes vetveten e identifikojnë më shumë me Serbinë, përkatësisht Kroacinë, sesa me Bosnjen.[49] Që nga fundi i luftës, ka patur veprime të panumërta të serbëve dhe kroatëve që e sfidonin integritetin territorial shtetëror dhe që ia rrëmihnin themelet funksionimit të BeH si një shtet i përbashkët. Udhëheqësit e RS kanë kërcënuar vazhdimisht me referendum për pavarësi sa herë që ata ishin të pakënaqur me vendimet e shtetit të BeH apo të OHR.[50] Nga ana tjetër, pasi dështuan ta krijojnë entitetin e tretë – Republikën Kroate të Herceg-Bosnjes – kroatët në masën më të madhe e kanë shpërfillur Federatën dhe në vend të saj janë përqendruar në nxjerrjen përfundimtare të entitetit të tretë nga shteti duke ndjekur fushata jorealiste për konsolidimin e kantoneve që i kontrollonin.[51]

Paqja ndërmjet etnive në konflikt dhe rivendosja e besimit midis popujve e paraqet njërin ndër parakushtet vendimtare për ta rindërtuar shoqërinë e Bosnjes pas luftës. Megjithatë, fakti që gjatë luftës çdokush luftonte kundër çdokujt, procesin e pajtimit e bënte jashtëzakonisht të vështirë.[52] Ndërkohë që krimet e luftës në një mënyrë të qartë ishin kryer nga të gjitha palët, boshnjakët padyshim pësuan më së shumti viktima.[53] Mizori të tilla të luftës që e synonin spastrimin etnik dhe copëtimin e BeH e kanë fuqizuar edhe më tutje ndjenjën boshnjake të pronësisë dhe të unitetit të vendit, meqë këta ndarjen ende e shoqërojnë me mizoritë e luftës dhe të spastrimit të dhunshëm etnik.[54] Megjithatë, çështja e etnisë vazhdon t'i përshkojë të gjitha aspektet e jetës së përditshme. Aspektet sociale dhe ekonomike të jetës vazhdimisht bijnë në hije të një etno-nacionalizmi të fuqishëm. Në një mënyrë evidente, vendi ka një nevojë urgjente për reforma rrënjësore kushtetuese. E ashtuquajtura 'Pranvera Boshnjake' e vitit 2014 pë në plan të parë solli protestat anti-qeveritare u pa nga shumëkush si shenja e parë e një uniteti të mirëfilltë që i tejkalon ndarjet etnike; në raporte të shumta pohohej që demonstruesit i mbanin që të tre flamurët, atë boshnjak, serb dhe kroat, njërin pranë tjetrit. Këto protesta, në fakt, paraqisnin një revoltë kundër elitave nacionaliste dhe politike, qëllimet individuale të të cilave perceptohen se janë në kundërshtim me mirëqenien e qytetarëve.[55] Për më tepër, lufta, e vijuar nga makiazhi aktual kushtetues, ka çuar në një hapësirë ku shumica e popullatës së BeH është e parandaluar nga pjesëmarrja në çfarëdo veprimi domethënës politik dhe qytetar pa strukturat ndërmjetëse, edhe të niveleve të ndryshme të qeverisjes, edhe të vetë agjentëve politikë dhe qeveritarë. Kjo është kështu meqë, në instancë të fundit, rezultati përfundimtar i luftës

---

[49] Për shembull, vetëm 13 përqind e serbëve idenitifikohen me BeH, ndërkohë që deri në 70 përqind identifikohen me kombësinë serbe, ortodoksinë dhe Republikën Serbe; shih ICG Report N°214, 2011, fq. 11.
[50] Nga të gjithë politikanët, Milorad Dodik, Presidenti i RS, është ai që referendumin e ka përkrahur më së shumti; shih ICG Report N°214, 2011, fq. 13-16.
[51] ICG Europe Report N°209, 2010, fq. 2-3.
[52] Edhe pse fillimisht boshnjakët dhe kroatët luftuan së bashku kundër serbëve, pas vitit 1993 ata zhvilluan luftë kundër njëri-tjetrit; ICG Europe Report N°209,2010, fq. 2.
[53] Edhe pse të dhënat për viktimat dallojnë në masë të konsiderueshme, myslimanët i kanë pësuar humbjet më të mëdha prej 57,992 vetash (3.1% të popullatës së regjistrimit të vitit 1991), viktimat serbe janë 19,398 (1.4%), ndërkaq kroatët i patën humbjet më të vogla prej 7,543 vetash (rreth 1 përqind); për një analizë të hollësishme për viktimat e luftës në BeH shih Jan Zwierzchowski dhe Ewa Tabeau, "The 1992-95 War in Bosnia and Herzegovina: Census-based multiple systems estimation of casualties undercount," Conference Paper for the International Research Workshop on "The Global Costs of Conflict," Berlin, 1-2 shkurt 2010.
[54] Kivimäki me të tjerë, 2012, fq. 16.
[55] Ginnell, Luke, "*Bosnia Divided*," Roads & Kingdoms, 2014; http://roadsandkingdoms.com/2014/bosnia-divided/ (22.12.2014).

dhe i kushtetutës pasuese ka qenë izolimi sistematik i popujve përbërës të BeH (dhe, më e rëndësishmja, e boshnjakëve dhe serbëve) nga njëri-tjetri; së pari, ashtu siç tashmë është vërejtur, popullatat boshnjake dhe serbe janë vendosur në tërësi në anë të kundërta, në Federatën e BeH, përkatësisht në RS; dhe, së dyti, fakti që statusi shtetformues në nivelin e entitetit ishte i ndryshëm nga ai në nivelin e vendit don të thotë që tre popujt shtetformues të BeH nuk kanë themel të përbashkët për të komunikuar si popuj shtetformues. Problemi kryesor i BeH vis-à-vis marrëdhënieve ndëretnike është ai që çdo rast i dialogut ndëretnik ndodh në një kuadër ku vetëm njëri grup etnik funksionon si shumicë dhe si element shtetformues legal, ndërkaq tjetri funksionon pikërisht si e thotë edhe vetë fjala: si "tjetri."

## 4. Kroacia

Edhe përkundrejt pranisë së minoriteteve të tjera në vend, marrëdhëniet ndëretnike në Kroaci ishin dhe vazhdojnë të jenë kryesisht të përcaktuara nga marrëdhëniet midis kroatëve dhe serbëve etnikë. Në parim, marrëdhëniet ishin të shënuara nga konflikti për territor, që nga krijimi e deri te shpërbërja e ish-Jugosllavisë, dhe serbët etnikë në Kroaci kanë ngulmuar vazhdimisht, qoftë në autonominë territoriale të territoreve të mbizotëruara nga serbët në Kroaci, qoftë në secesionin e tyre të plotë. Duhet përmendur që marrëdhëniet midis serbëve dhe kroatëve e kanë një histori të hidhur që shkon prapa në Luftën e Dytë Botërore. Gjatë kësaj periudhe, serbët në Kroaci ishin viktima të persekutimeve, shpërnguljes dhe madje edhe të ekzekutimeve masive.[56] Rrjedhimisht, marrëdhëniet midis shumicës kroate dhe serbëve lokalë janë shënuar me frikë dhe dyshim të ndërsjellë që nga vetë krijimi i Jugosllavisë socialiste. Nga njëra anë, kroatët i frikësoheshin mbizotërimit serb, ndërkaq serbët, nga ana tjetër, ishin përplot ankth për ndonjë përsëritje të mundshme të 1941-it, dhe Jugosllavinë socialiste e shihnin si garantuese të sigurisë së tyre personale dhe kombëtare. Në fakt, menjëherë pas luftës, serbët etnikë kishin kërkuar një krahinë autonome serbe brenda Kroacisë. Ndërkohë që kërkesa e tyre u refuzua, në vitin 1971 pretendimet e tilla u shfaqën sërish gjatë të ashtuquajturës Pranverë Kroate. E qartë, edhe pse serbët e paraqisnin vetëm 12.2 përqind të popullatës së tërë të Kroacisë, ata ishin një faktor politik i fuqishëm, që jetonte në zona të përqendruara, dhe që duhej të merrej seriozisht.[57]

Fillimi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, dhe i dëshirës së Kroacisë për pavarësi, i ripërtëriti pretendimet e serbëve në Kroaci për autonomi territoriale. Propozimet e serbëve për autonomi shtriheshin në diapazonin nga autonomia e kufizuar kulturore e deri te autonomia e gjerë territoriale dhe politike për pjesë të gjera të Kroacisë. Nga ana tjetër, forcat më radikale serbe në një mënyrë të

---

[56] Për shkak të kësaj periudhe gjatë Shtetit të Pavarur të Kroacisë (NDH), çdo thirrje për rritjen e të drejtave kombëtare në Kroaci është emërtuar si "nacionaliste" dhe "ekstremiste," në kohën kur kroatët shpesh herë janë emërtuar si ustashë; shih Bjelajac, Mile dhe Žunec, Ozren "The War in Croatia, 1991-1995," Round table in Zagreb, Scholars Initiative report, 20 tetor 2007, fq. 9.

[57] Huszka, Beáta, *Secessionist movements and ethnic conflict: debate-framing and rhetoric in independence campaigns*, New York: Routledge, 2014, fq.76.

qëndrueshme autonominë brenda shtetit të pavarur kroat e merrnin si tërësisht të papranueshme.[58] Rrjedhimisht, një ditë para ratifikimit të Kushtetutës së Kroacisë, Bashkësia e Komunave e zgjodhi autonominë territoriale brenda Kroacisë, duke e shpallur Rajonin Autonom Serb (SAO) të Krajinës.[59] Një ditë më vonë, më 25 qershor 1991, Kroacia e shpalli pavarësinë e vet dhe serbëve në Kroaci u garantoi respektimin e të gjitha të drejtave njerëzore dhe qytetare. Pas kësaj, me qëllim të kënaqjes së kërkesave për njohje ndërkombëtare, Parlamenti i Kroacisë e kaloi *Ligjin Kushtetues për të Drejtat dhe Liritë Njerëzore*, dhe u dha një status autonom rajoneve të Kninit dhe të Glinës.[60] Mirëpo, të frikësuar nga politikat nacionaliste të Tugjmanit, nga njëra anë, dhe të nxitur nga përkrahja politike dhe ushtarake nga Serbia, nga tjetra, serbët në Kroaci i radikalizuan kërkesat e tyre edhe më shumë. Si pasojë, më 18 mars 1991, Kuvendi Komunal i Kninit e përvetësoi vendimin për ta shkëputur SAO Krajinën nga Kroacia, duke çuar kështu në një luftë ndëretnike midis kroatëve, nga njëra anë, dhe kryengitësve etnikë serbë dhe Armatës Popullore të Jugosllavisë (JNA), nga tjetra.[61]

I inkurajuar nga përparimet fillestare të luftës, parlamenti i SAO Krajinës, rrjedhimisht, më 19 dhjetor 1991 e shpalli Republikën e Krajinës Serbe, të cilës më vonë iu bashkangjitën SAO e Sllavonisë, Baranjës dhe e Sremit Perëndimor dhe SAO e Sllavonisë Perëndimore.[62] Për t'i parandaluar viktimat dhe mizoritë, në janar të vitit 1992 u bë marrëveshja e armëpushimit dhe vendosja e Forcës Mbrojtëse të Kombeve të Bashkuara (UNPROFOR). Që nga atëherë, vijat frontale efektivisht u ngrinë dhe deri në vitin 1995 luftimi u bë në masë të madhe sporadik. Megjithatë, duhet përmendur që gjatë kësaj periudhe territoret e kontrolluara nga serbët paraqisnin rreth 30 përqind të territorit të Kroacisë.[63] Në ndërkohë, si një përpjekje për ta përfunduar luftën, serbëve iu ofrua një autonomi e lartë sipas planit të ashtuquajtur Z4 që u përpilua nga i ashtuquajturi "Mini-Kontakt Grupi."[64] Plani propozonte një autonomi të gjerë për zonat me shumicë serbe sipas regjistrimit të vitit 1991. Pos kësaj, serbëve iu premtua valuta e veçantë, parlamenti i tyre, forca policore, politika fiskale, dhe lidhjet me Serbinë. Edhe pse Sllavonia Lindore nuk mbulohej nga arranzhimi i kësaj autonomie të gjerë, planifikohej që forcat ndërkombëtare të vendoseshin në rajon për një periudhë prej pesë vitesh.[65] Edhe përkundrejt gatishmërisë së Beogradit për ta pranuar këtë propozim, serbët radikalë në Kroaci e refuzuan këtë, me shpresë të shkëputjes së plotë nga Kroacia. Si kundërpërgjigje, në majin e vitit 1995 trupat kroate e filluan operacionin ushtarak Vetëtima, dhe e morën kontrollin mbi Sllavoninë Perëndimore. Në një gjendje të dëshpërimit, në qershor 1995 Parlamenti i RSK votoi unanimisht për të krijuar union me serbët e Bosnjes, edhe përkundrejt

---

[58] Caspersen, Nina, "The Thorny Issue of Ethnic Autonomy in Croatia: Serb Leaders and Proposals for Autonomy," *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, Issue 3, 2003, fq. 1.

[59] Autonomisë territoriale iu dha trajta e vet e parë kur në fund të prillit të vitit 1990 u themelua Bashkësia e Komunave (serbe) të Dalmacisë dhe Likës, edhe pse udhëheqësi i atëhershëm i serbëve në Kroaci, Rašković mohonte që kjo Bashkësi është ndonjë shprehje e autonomisë territoriale, dhe argumentonte që në vend të kësaj kjo mund ta trajtësonte themelin për autonomi kulturore; shih Rašković, J., *Luda Zemlja*, Beograd: Akvarijus, 1990, fq. 311.

[60] Caspersen, 2003, fq. 11.

[61] Për një shqyrtim të hollësishëm për luftën 1991-1995 në Kroaci, shih Bjelajac dhe Žunec, 2007.

[62] Petricusic, Antonija, "Nation-Building in Croatia and the Treatment of Minorities: Rights and Wrongs," *L'Europe en Formation*, *Journal of Studies on European Integration and Federalism*, Issue 3, 2008, fq. 136.

[63] Hudson, Kate, *Breaking the South Slav dream: the rise and fall of Yugoslavia*, London: Pluto Press, 2003, fq. 90.

[64] Përfaqësuesit e SHBA, Rusisë, të UE-së dhe të KB nga Konferenca Paqësore për ish-Jugosllavinë.

[65] Caspersen, 2003, fq. 13.

kundërshtimit të Beogradit. Mirëpo, më 14 gusht, Kroacia u kundërpërgjigj me operacionin Furtuna me të cilin e morën sërish Krajinën për vetëm disa ditë, duke e shkaktuar një ekzod masiv të serbëve jashtë Kroacisë, për në Bosnje dhe në Serbi.[66] Pjesa e mbetur e RS të Krajinës, Sllavonia Lindore, si i vetmi territor nën kontrollin serb u vu nën administrimin tranzicional të KB (UNTAES), dhe u kthye prapa nën administrimin e Kroacisë në janar 1998.

Një kësi realiteti i transformoi marrëdhëniet ndëretnike midis kroatëve dhe serbëve nga një konflikt për territor në një konflikt për të drejta minoritare. Pas rimarrjes së kontrollit mbi territoret deri atëherë të kontrolluara nga serbët, qeveria kroate e filloi shkurtimin e autonomisë dhe të përfaqësimit politik që iu ishte dhënë serbëve në Ligjin Kushtetues të vitit 1991. Rrjedhimisht, dispozitat për përfaqësimin proporcional dhe statusin special të qarqeve të caktuara u suspenduan deri në regjistrimin e ardhshëm.[67] Për më tepër, politika jotolerante dhe shoviniste ndaj minoriteteve kombëtare (dhe posaçërisht ndaj atij serb) si dhe forma të shumta të diskriminimit u ndoqën përgjatë të tërë kësaj periudhe.[68] Ashtu siç u raportua nga Human Rights Watch në vitin 1999, si rezultat i politikave dhe praktikave diskriminuese, pas luftës serbët mbetën qytetarë të klasit të dytë në Kroaci.[69] Nga ana tjetër, i vetëdijshëm për realitetin e krijuar rishtas, Këshilli Kombëtar Serb (SNV) i themeluar në korrik 1997 si një shoqatë-ombrellë e shoqatave serbe dhe e përfaqësuesve të tyre politikë, pranoi që autonomia territoriale nuk ishte as e arritshme, as e mundshme, dhe prandaj e qartësoi që qëllimi kryesor i Këshillit ishte autonomia personale krahas me mekanizmin e këshillave komunalë.[70]

Si pasojë e luftës, numri i serbëve që jetonin në Kroaci u ul në një mënyrë dramatike, ndërkohë që ata që mbetën ishin, në parim, të shkapërderdhur anembanë vendit. Sipas regjistrimit të fundit në 2011, përqindja e serbëve është zvogëluar nga 12.6 përqind në 4.36 përqind. Mirëpo, duhet përmendur që lufta e ka ndryshuar në mënyrë drastike të tërë strukturën e popullatës së Kroacisë: popullata e tërësishme është ulur nga 4,784,265 në vitin 1991, në 4,456,096 në vitin 2011. Përqindja e minoriteteve në vend është zvogëluar po ashtu, dhe sipas regjistrimit të fundit, pos serbëve, të gjitha 21 minoritetet që jetojnë në Kroaci paraqesin më pak se 1 përqind të popullatës së tërë. Ashtu siç pritej, për shkak të zvogëlimit të konsiderueshëm të popullatës minoritare dhe migrimit në rrjedhje e sipër të kroatëve nga pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë, në Kroaci, numri i tërësishëm i kroatëve është rritur në mënyrë domethënëse, nga 78.1 përqind në vitin 1991, në 90.42 përqind në vitin 2011.[71] Megjithatë, është evidente që minoriteti serb numerikisht është tkurrur tepër shumë, ndërkohë që

---

[66] Dhjetra mija serbë u arratisën menjëherë pas disfatës së armatës së RKS, ndërkohë që vlerësohet që 300,000 deri në 350,000 serbë e lanë Kroacinë gjatë luftës; për një shpjegim të hollësishëm të operacioneve Vetëtima dhe Furtuna, shih Žunec, Ozren, "Operations Flash and Storm', në Magaš dhe Žanić, *The War in Croatia and Bosnia-Herzegovina 1991-1995*, New York: Frank Cass Publishers, 2001, fq. 71.
[67] Shih, për shembull, Trifunovska, Snezana, "Minority Rights in Croatia." *International Journal of Minority and Group Rights* 6(4), 1999, fq. 474-5.
[68] Tatalović, Sinisa, "National Minorities and Croatian Democracy," *Politička misao*, Vol. XLIII, No. 5, 2006, fq. 46.
[69] Human Rights Watch, *Croatia*: *Second Class Citizens - The Serbs of Croatia*, 1 mars 1999, fq. 3; http://www.hrw.org/reports/1999/03/01/second-class-citizens (17.12.2014).
[70] Caspersen, 2003, fq. 18.
[71] Shih Byronë Kroate të Statistikave, http://www.dzs.hr/default_e.htm (17.12.2014).

pozita e tij është shumë më e keqe se në vitin 1990. Padyshim, një zvogëlim kaq përmbajtësor është pasojë e luftës: shumica e serbëve u dëbuan dhe u arratisën nga vendi, pas luftës janë kthyer fare pak nga ta, ndërkohë që të tjerët në fund u asimiluan. Pos kësaj, që nga fitoret ushtarake në vitin 1995 dhe reintegrimit paqësor të Sllavonisë Lindore dhe Baranjës në vitin 1998, qeveria kroate e ka rivendosur kontrollin e plotë në të tërë territorin e vendit, ndërkohë që serbët ishin nën trysninë e vazhdueshme ndërkombëtare dhe pa përkrahje nga Beogradi.[72]

Deri më tash, pas ndërrimit të partisë në pushtet në vitin 2000, Kroacia lëvizi drejt një tranzicioni të mirëfilltë politik, që e krijoi, po ashtu, momentin për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve kombëtare. Pos kësaj, rregullimi legjislativ dhe përmbushja praktike e të drejtave të minoriteteve kombëtare u shndërrua në një nga parakushtet politike për integrimin e Kroacisë në UE dhe në NATO. Marrë në tërësi, kjo çoi në krijimin dhe implementimin e politikave të minoriteteve që synonin integrimin e minoriteteve kombëtare në shoqërinë kroate si dhe ruajtjen e identiteteve të tyre kombëtare.[73] Si rezultat, në majin e vitit 2001 u miratua "Ligji për Shfrytëzimin e Gjuhës dhe Shkrimit të Minoriteteve Kombëtare në Republikën e Kroacisë," ndërkaq, "Ligji Kushtetues për të Drejtat e Minoriteteve Kombëtare" që u prit për një kohë të gjatë (LKMK) u kalua në dhjetorin e vitit 2002, duke e krijuar kësisoj një kornizë normative gjithëpërfshirëse për ushtrimin e të drejtave minoritare në vend.[74] Pos kësaj, pjesëtarëve të komuniteteve kombëtare në Kroaci iu garantua e drejta për përfaqësim në trupat përfaqësues të vetëqeverisjes lokale dhe në trupat përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes rajonale.[75]

Aktualisht, serbëve në Kroaci u garantohen autonomia kulturore, përfaqësimi proporcional dhe një trajtë fare e limituar e autonomisë territoriale. Ndërkohë që kjo është e ngjashme me disa nga kërkesat e bëra nga serbët heret në vitet 1990, kjo është shumë më pak se kërkesat e tyre maksimaliste të bëra në fazat e ndryshme të konfliktit.[76] Pakënaqësia kryesore në mesin e përfaqësuesve politikë të serbëve në Kroaci ka të bëjë me faktin që serbët e kanë humbur statusin shtetformues që paraprakisht e kishin në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë deri në vitin 1990. Ndërkohë që gjatë ish-Jugosllavisë, Kushtetuta e Republikës së Kroacisë këtë e përcaktonte si shtet kombëtar të popullit kroat, shtet të popullit serb, dhe shtet të popujve dhe kombësive të tjera që jetojnë në të, Kushtetuta e re e Kroacisë serbët i ka privuar nga statusi i tyre si popull shtetformues.[77] Pos kësaj, serbët ankohen, po ashtu, që për shkak të mungesës së vullnetit politik, zbatimi i LKMK në masë të madhe ka mbetur shkronjë e vdekur në letër. Pritjet janë plotësuar posaçërisht sa i përket Këshillave të Minoriteteve Kombëtare në nivelin lokal dhe rajonal, meqë autoritetet lokale dhe rajonale këta nuk i konsideruan si partnerë serioz.[78] Pos kësaj, minoriteti serb është, po ashtu, i ndikuar nga vonesat dhe nga problemet lidhur me zbatueshmërinë sa i përket

---

[72] "Croatia Country Report," Bertelsmann Stiftung's Transformation Index (BTI), 2014, fq. 6.
[73] Tatalović, 2006, fq. 46.
[74] *Ibid.*, fq. 49.
[75] Constitutional Law on the Rights of National Minorities, *Official Gazette,* 155/2002, Article 19 and 20.
[76] Caspersen, 2003, fq. 20.
[77]See *Constitution of the Republic of Croatia*, 22 dhjetor 1990; http://www.refworld.org/docid/ 3ae6b551c.html (18.12.2014).
[78] Minority Rights Group International, *World Directory of Minorities and Indigenous Peoples - Croatia: Overview*, 2008; http://www.refworld.org/docid/4954ce1ec.html (17.12.2014).

të drejtave pronësore. Në fakt, sipas "Aktit për Marrjen dhe Administrimin e Përkohshëm të Pronës," "e tërë prona e tundshme dhe e patundshme në territorin paraprakisht të pushtuar të Republikës së Kroacisë ishte vënë nën administrimin e përkohshëm të shtetit, ndërsa qytetarëve, prona e të cilëve ishte marrë në një kësi mënyre, u ishte dhënë një afat statutar prej 8 ditësh për të bërë apele kundër vendimeve të tilla." Një kësi afati për apelim, që ishte i shkurtër në një mënyrë absurde, e bëri të pamundshme për refugjatët serbë që jetonin jashtë vendit që t'i kërkonin pronat e tyre. Kjo, më tutje, ndikoi në një mënyrë të konsiderueshme në të tërë procesin e kthimit të refugjatëve serbë në shtëpitë e tyre.[79] Edhe pse qeveria kroate pretendon që 96,500 serbë janë kthyer deri në nëntorin 2002, është e qartë që kjo shifër e mbivlerëson numrin aktual të të kthyerve, meqë shumë prej tyre, pas një qëndrimi të shkurtër, kanë shkuar përsëri në Bosnje, në Serbi apo në Mal të Zi.[80] Sipas *Minority Rights Group International*, në vitin 2006, 85,000 serbë etnikë kanë mbetur të zhvendosur, si dhe zyrtarisht të regjistruar si të tillë në vendet fqinje.[81]

Përfaqësimi politik e paraqet një aspekt tjetër të të drejtave të minoriteteve për të cilin serbët ankohen. Qytetarët kroatë që u takojnë minoriteteve etnike kanë të drejtë për të zgjedhur nëse dojnë të votojnë për listën zgjedhore në zonën zgjedhore në pajtim me vendbanimin e tyre, apo të votojnë për kandidatët e minoriteteve etnike në zonën e veçantë të 12 zgjedhore. Sipas Ligjit Kushtetues, minoriteteve numri i të cilave i tejkalon 8 përqind të popullatës së tërë të Kroacisë u garantohet përfaqësimi proporcional në Parlamentin Kombëtar Kroat, në Qeverinë e Republikës së Kroacisë dhe në trupat e autoritetit gjyqësor. Nga ana tjetër, sipas Ligjit për Zgjedhjen e Përfaqësuesve në Parlamentin Kombëtar Kroat, "Pjesëtarët e komuniteteve etnike dhe kombëtare apo minoritetet pjesa e të cilave në popullatën e Republikës së Kroacisë është nën 8% do ta kenë të drejtën për t'i zgjedhur, të paktën pesë, dhe më së shumti shtatë, përfaqësues në Dhomën e Përfaqësuesve të Parlamentit Kombëtar Kroat."[82] Rënia domethënëse e popullatës serbe shumë nën pragun prej 8 përqind, dispozitën e parë e bën të pazbatueshme. Nga ana tjetër, edhe përkundrejt qartësisë së dispozitës së dytë, gjatë mandatit 2000-2004 në Parlamentin Kroat ishte vetëm një ulëse e rezervuar për minoritetin serb.[83] Megjithatë, situata lidhur me përfaqësimin politik të serbëve është përmirësuar gradualisht, dhe aktualisht, pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në dhjetor 2011, serbët i kanë 3 ulëse në parlament.

Duhet të përmendet që, si i vetmi anëtar i Unionit Evropian nga shtatë vendet e shqyrtuara, Kroacia kohëve të fundit ka arritur një përparim serioz në sistemin e vet për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve kombëtare si pjesë e kornizës së vet legale dhe legjislative, në kohën që është përpjekur

[79] "The Position of National Minorities in the Republic of Croatia - Legislation and Practice," Ombudsman Report, Republic of Croatia, Zagreb, prill 2008, fq. 6-7.
[80] Caspersen, 2003, fq. 15.
[81] Minority Rights Group International, 2008.
[82] Constitutional Law on Human Freedoms and Rights and Rights of Ethnic and National Minorities, 2000, Article 17.
[83] Djuric, Ivana, "Local Governance, Integration and Participation of Croatian Serbs: In search of a prosperous model," Punim i dhënë në Konferencën e 10 vjetore të NISPAcee "Delivering Public Services in CEE Countries, Trends and Developments," Krakov, Poland, prill 2002, fq. 2.

t'i japë një konsideratë maksimale pikëpamjeve të minoriteteve kombëtare.[84] Megjithatë, herë pas here shpirtërat e së kaluarës zgjohen dhe tendosjet etnike midis kroatëve dhe serbëve shfaqen sërish. Kohëve të fundit kemi qenë dëshmitarë të një rasti të tillë lidhur me shfrytëzimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të minoritetit kombëtar serb në qytetin e Vukovarit. Në bazë të pjesës minimale prej një të tretës së personave që u takojnë minoriteteve kombëtare në popullatën lokale, qyteti i Vukovarit është i obliguar sipas ligjit që ta përcaktojë shfrytëzimin e barabartë zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të minoritetit kombëtar serb. Mirëpo, përkundrejt dispozitave ligjore, qeverisja e qytetit të Vukovarit në nëntorin e vitit 2013 ka miratuar amandamente në kartën e vet, që këtë e përjashtojnë nga obligimi për të siguruar shfrytëzimin e barabartë zyrtar të gjuhës serbe dhe të shkrimit qirilik.[85] Reagimi i shpejtë i Ministrisë së Administrimit Publik, që e suspendoi zbatimin e këtyre dispozitave nxiti protesta masive anembanë vendit, të udhëhequra nga veteranët e luftës. Kur autoritetet lokale në fund filluan t'i vendosin shenjat dygjuhësore në ndërtesat e administrimit publik në Vukovar, tendosjet u rritën edhe më tutje. Edhe përkundrejt qëndrimit të vendosur të qeverisë qendrore lidhur me këtë çështje, veteranët nisën fushata duke kërkuar që të drejtat lidhur me gjuhët minoritare duhej të zbatoheshin vetëm në vendet ku të paktën gjysma e popullatës ishte nga minoriteti etnik, ndërkohë që vazhdonin t'i shkatërronin shenjat dygjuhësore kudo që ato ishin të rivendosura.[86] Edhe pse në gushtin 2014 Gjykata Kushtetuese e Kroacisë i refuzoi kërkesat për referendum për kufizime më të ngushta për shfrytëzimin e shenjave me shkronja qirilike në zonat e Kroacisë të populluara me minoritetin serb,[87] incidentet e tilla janë një përkujtues i zymtë për atë se sa të brishta janë marrëdhëniet ndëretnike midis kroatëve dhe serbëve në vend.

## 5. Kosova

Historikisht, konflikti ndëretnik në Kosovë është bërë ekskluzivisht për territorin e saj. Të dyja palët, serbët dhe shqiptarët, kanë shprehur pretendime për historinë dhe etno-demografinë, për të përligjur të drejtën e tyre të hamendësuar si ekskluzive mbi këtë territor etnikisht të përzier. Sipas Konferencave të Londrës (1913), Versajës (1919) dhe të Parisit (1946), edhe përkundrejt vullnetit të lirë të popullatës së vet (shqiptare), Kosova është bërë pjesë e Jugosllavisë.[88] Pas Luftës së Dytë Botërore, me themelimin e Jugosllavisë komuniste, shqiptarëve të Kosovës u është dhënë një shkallë e autonomisë në kuadrin e Serbisë. Pas demonstratave të shqiptarëve që në vitin 1968 e kërkonin

[84] Për hollësi shih "Third Opinion on Croatia," ACFC/OP/III(2010)005, Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, 6 dhjetor 2010; shih, po ashtu, "Fourth Report of the Republic of Croatia on the Implementation of the Framework Convention for the Protection of National Minorities," ACFC/SR/IV(2014)012, Government of the Republic of Croatia, korrik 2014.
[85] "Fourth Report of the Republic of Croatia on the Implementation of the Framework Convention for the Protection of National Minorities," 2014, fq. 65.
[86] Pavelic, Boro, "Croatia: Serbian Language Dispute Creates Discord," *Balkan Insight*, 26 dhjetor 2013; http://www.balkaninsight.com/en/article/croatia-serbian-language-dispute-sparks-discord (20.12.2014).
[87] Ilic, Igor, "Croatia rejects demand for referendum to restrict Cyrillic signs," Reuters, 12 gusht 2014; http://news.yahoo.com/croatia-rejects-demand-referendum-restrict-cyrillic-signs-160846457.html (20.12.2014).
[88] Fillimisht si pjesë e monarkisë jugosllave, dhe, pas Luftës së Dytë Botërore, si pjesë e Jugosllavisë së re socialiste. Për hollësi shih, Hivzi Islami, "Demographic Reality of Kosovo," në Dusan Janjic dhe Shkelzen Maliqi, red., *Conflict or Dialogue: Serbian-Albanian Relations and Integration of the Balkans*, Subotica: Open University, European Civic Centre for Conflict Resolution, 1994, fq. 30

statusin e republikës për Kosovën, në vitin 1974 kushtetuta jugosllave ia dha Kosovës një autonomi përmbajtësore. Edhe pse teknikisht ende brenda Serbisë, rajonit, në realitet, iu dha një status i ngjashëm me atë të republikave përbërëse të federatës, gjë kjo që e mundësoi një afirmim politik dhe kulturor të shqiptarëve. Pas vdekjes së Titos, në një varg demonstratash në vitin 1981 ata përsëri e kërkuan ngritjen e statusit të Kosovës në republikë në kuadrin e federatës. Demonstratat u shtypën në një mënyrë mizore nga forcat policore dhe ushtarake, u shpall gjendja e jashtëzakonshme, dhe me mija shqiptarë, kryesisht të rinj u dënuan me dënime të rënda me burg. Kur autonomia e Kosovës u mor me forcë në vitin 1989, konflikti e arriti një shkallë të re të intensitetit, dhe shqiptarët, brenda një kohe fare të shkurtër, u përjashtuan nga vendet e punës, atyre iu mohua edukimi në gjuhën e tyre, dhe iu nënshtruan një shkeljeje masive të të drejtave të tyre njerëzore dhe të lirive qytetare.[89]

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë në vitin 1991, shqiptarët e Kosovës organizuan referendum ku e zgjodhën pavarësinë. Nga ana tjetër, autoritetet serbe ngulmuan në statusin kushtetues të Kosovës si një pjesë përbërëse e Serbisë. Edhe përkundrejt paralajmërimeve nga studiues dhe vrojtues politikë të shumtë për përshkallëzimin e mundshëm të dhunës, bashkësia ndërkombëtare u dëshmua si e paaftë për ta parandaluar atë. Rrjedhimisht, nga shkurti 1998 e më tutje, Kosova u gllabërua në një konflikt të armatosur të një shkalle të gjerë midis Ushtrisë guerile Çlirimtare të Kosovës të shqiptarëve, nga njëra anë, dhe forcave të policisë speciale si dhe njësive të rregullta të ushtrisë jugosllave, nga tjetra.[90] Me qëllim që ta ndalojë spastrimin etnik të Kosovës dhe ta përfundojë katastrofën humanitare, NATO-ja më 24 mars 1999, e nisi fushatën ushtarake ajrore 78-ditëshe që i merrte në shënjestër forcat ushtarake të RFJ-së dhe infrastrukturën e Serbisë. Më 3 qershor 1999, Parlamenti i RFJ-së e miratoi Planin Ahtisari-Çernomirdin, që e përfshinte tërheqjen e plotë (të verifikueshme) të forcave ushtarake të RFJ-së nga Kosova, kthimin e sigurtë të të gjithë refugjatëve, dhe misionin civil të KB për ta zbatuar planin paqësor të Marrëveshjes së Rambujesë, që do të sigurohej nga trupat e NATO-s.[91] Megjithatë, pasojat e luftës ishin tragjike: të paktën 10,000 njerëz ishin vrarë, rreth 800,000 ishin bërë refugjatë apo persona të zhvendosur, dhe pjesë të mëdha të vendit ishin shkatërruar.[92] Nga ana tjetër, mandati i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) që synonte ta administronte Kosovën pa e paragjykuar statusin e saj të jashtëm ishte pothuaj i paprecedent sipas standardeve të operacioneve të KB në terren. Jo vetëm që ky u fuqizua ta merrte të tërë përgjegjësinë e plotë administrative të përkohshme mbi territorin e Kosovës, por këtij iu dha një rol qendror politik në zgjidhjen e konfliktit.[93] Meqë bashkësia ndërkombëtare luftën e perceptoi si një konflikt etnik, "multietniciteti" ishte njëri nga qëllimet kryesore të pranisë

[89] Demjaha, Agon "Kosovo: A Perspective from Inside," në Ramesh Thakur dhe Albrecht Schnabel red., Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship, United Nations University Press, Tokyo, dhjetor 2000, fq. 33.
[90] Calic, Marie-Janine, "Kosovo in the twentieth century: A historical account," në Ramesh Thakur dhe Albrecht Schnabel red., Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship, United Nations University Press, Tokyo, dhjetor 2000, fq. 19.
[91] Selatin Kllokoqi, Blerim Ahmeti, Glauk Konjufca dhe Valon Murati, "Glauk Konjufca The Role of Human and Minority Rights in the Process of Reconstruction and Reconciliation for State and Nation-Building: Kosova, "Human and Minority Rights in the Life Cycle of Ethnic Conflicts, shkurt 2008, fq. 4.
[92] Calic, 2000, fq. 19.
[93] Yannis, Alexandros, "The UN as Government in Kosovo," *Global Governance* 10, 2004, fq. 67.

ndërkombëtare në Kosovë. Ndërkohë që UNMIK-u gjithmonë kërkonte tolerancë dhe respektim të ndërsjellë midis komuniteteve të ndryshme në Kosovë, strategjia e administrimit ndërkombëtar të Kosovës çoi në një izolim më të madh midis shqiptarëve dhe serbëve. Nën administrimin e UNMIK-ut u krijuan "enklavat serbe," ku "Kosova e Veriut ishte më e madhja dhe më e mundimshja prej tyre.[94]

Më 26 mars 2007, pas më tepër se një viti të negociatave të pasuksesshme të sponsoruara nga Kombet e Bashkuara midis Serbisë dhe Kosovës për ta arritur një zgjidhje politike për statusin e Kosovës, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari e përgatiti Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Ndërkohë që e përsëriste që pavarësia ishte e vetmja mundësi e qëndrueshme, raporti e pranonte kapacitetin e kufizuar të Kosovës për ta siguruar mbrojtjen e minoriteteve, për të zhvilluar institucione të qëndrueshme demokratike, për ta rritur ekonominë, dhe për ta arritur pajtimin ndëretnik. Në pajtim me këtë, Ahtisaari propozonte që ushtrimi i pavarësisë së Kosovës dhe zbatimi i tipareve konkrete të Propozimit Gjithëpërfshirës të "mbikëqyrej dhe përkrahej" nga autoritetet ndërkombëtare civile dhe ushtarake. Ai kërkonte një autoritet ndërkombëtar "të fuqishëm" por "të përqendruar" lidhur me të drejtat e komuniteteve, decentralizimin, mbrojtjen e Kishës Ortodokse Serbe, dhe sundimin e ligjit. Këto autoritete ndërkombëtare do ta kishin pushtetin për 't'i përmirësuar veprimet,' domethënë, të bëjnë veto në vendimet qeveritare lokale "që do t'i shkelnin dispozitat e propozimit të Zgjidhjes dhe frymën në të cilën këto ishin përpiluar."[95] Pas përpjekjeve të pasuksesshme për përvetësimin e një rezolute të Këshillit të Sigurimit të KB, më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës e miratoi Deklaratën e Pavarësisë. Kjo Kosovën e shpallte si një republikë demokratike, sekulare dhe multi-etnike, që i pranonte në tërësi obligimet sipas propozimit të Ahtisaarit.[96]

Aktualisht, Kosova i njeh shtatë grupe etnike si minoritete zyrtare: serbët (1.5%), boshnjakët (1.6%), turqit (1.1%), ashkalinjtë (0.9%), goranët (0.6%), egjiptasit (0.6%) dhe romët (0.5%).[97] Mirëpo, këtu duhet përmendur që rezultatet e regjistrimit të vitit 2011 janë parë si kontraverze meqë këto i lanë jashtë katër komunat veriore me shumicë serbe të Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe të Mitrovicës Veriore. Kjo pjesërisht ndodhi për shkak të asaj që Serbia nuk ishte e interesuar që serbëve të Kosovës së veriut t'u bënte thirrje për të marrë pjesë në regjistrim. Në vend të kësaj, Serbia iu përkushtua mbajtjes së regjistrimit të vet në veriun e Kosovës, ashtu që ta përcaktonte vetë numrin e serbëve që jetonin aty.[98] Nga ana tjetër, rezultatet u kritikuan, po ashtu, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës që pohonte që numri aktual i shqiptarëve në Kosovë është më i madh se që është treguar në regjistrim. Rrjedhimisht, regjistrimi nuk i ka plotësuar pritjet e elitave

---

[94] Kllokoqi et al., 2008, fq. 12.
[95] Për më tepër hollësi lidhur me propozimin e Ahtisaarit shih, United Nations, "Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's Future Status," S/2007/168, 26 mars 2007.
[96] Tansey, Oisín, "Kosovo: Independence and Tutelage," *Journal of Democracy*, Vol. 20, No. 2, prill 2009, fq. 159.
[97] "Estimation of Kosovo Population 2012," *Press Release*, Kosovo Agency of Statistics, 6 mars 2013; http://esk.rks-gov.net/rekos2011/?cid=2,40 (16.11.2014).
[98] Karadaku, Linda, "Kosovo completes 2011 census without data from north," *SETimes*, 16 tetor 2012; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2012/10/16/ feature-04 (20.11.2014).

dhe institucioneve etno-nacionale, edhe në Kosovë, edhe në Serbi, meqë që të dyjat atë e panë si një mjet për legjitimimin e diskursit nacionalist të palës tjetër.[99] Megjithatë, ndërkohë që minoritetet e tjera, parimisht, dhe në themel, janë të integruara mirë në realitetin e ri të Kosovës së pavarur, është marrëdhënia midis shqiptarëve dhe serbëve ajo që i shkakton tendosjet kryesore ndëretnike në vend.

Ashtu siç tashmë është aluduar, numri i serbëve që jetojnë në Kosovë e paraqet burimin fillestar të mospajtimeve midis dy komuniteteve. Serbët pretendojnë numra shumë më të lartë, posaçërisht të serbëve që e kanë lënë Kosovën pas vitit 1999. Sipas regjistrimit të Kosovës të vitit 1981, ishin 77.4 përqind shqiptarë, 13.2 përqind serbë, dhe 9.3 përqind që ishin anëtarë të komuniteteve të tjera që jetonin në krahinë. Regjistrimi i fundit i organizuar në ish-Jugosllavi në vitin 1991, tregonte një popullatë të tërë prej 1,956,196 vetash. Sipas vlerësimeve të ish Institutit Federal të Statistikave, ishin 1,596,072 shqiptarë (81.6 përqind) (dhe këta, në fakt, nuk kishin marrë pjesë në regjistrim), ndërkohë që komuniteti i dytë ishte ai serb, me 194,190 veta (9.9 përqind).[100] Pas konfliktit të vitit 1999, një numër i konsiderueshëm i serbëve dhe i minoriteteve të tjera e lanë Kosovën dhe lëvizën në Serbi. Megjithatë, numrat lidhur me këtë çështje janë në tërësi të ndryshëm dhe kundërthënës. Sipas Qeverisë së Serbisë, Kosovën e kanë braktisur 230,000 serbë, ndërkohë që shifrat e ICG-së pohojnë që në Kosovë pas luftës kanë mbetur 97,000 serbë ndërkaq, rreth 100,000 kanë ikur. Nga ana tjetër, sipas Nismës Evropiane të Stabilitetit (ESI – The European Stability Initiative), në Kosovë ende jetojnë rreth 130,000 serbë, e që paraqesin 2/3 e të tërë popullatës serbe të para luftës në Kosovë.[101] Për më tepër, popullata serbe në Kosovë ka ndryshuar vazhdimisht, edhe për shkak të kthimit të tyre në Kosovë, edhe për shkak se shumë prej tyre vazhdojnë të largohen për shkak të pasigurisë ekonomike në Kosovë, dhe të perceptimeve të tyre që jashtë Kosovës e kanë në dispozicion një të ardhme më të qendrueshme.

Ndërkohë që numri i minoritetit serb mbetet një çështje tejet kontraverse dhe burim i tendosjeve të vazhdueshme midis Serbisë dhe Kosovës, realiteti tregon që numrat nuk janë forca kryesore shtytëse e tendosjeve ndëretnike midis shqiptarëve dhe serbëve. Në fakt, edhe pse shumica e serbëve në Kosovë jetojnë jashtë "Kosovës Veriore," është pjesa e atyre që jetojnë në të ajo që i jep zjarr problemeve kryesore në vend. Ndërkohë që serbët që jetojnë në pjesët e tjera të Kosovës kanë qenë më bashkëpunues dhe kanë filluar dalëngadalë të integrohen në realitetin e Kosovës, pjesa veriore e Kosovës vazhdon të karakterizohet nga tendosje dhe shpërthime periodike të dhunës. Pos kësaj, qyteti i ndarë i Mitrovicës ka qenë vazhdimisht një pikë e nxehtë e tendosjeve ndëretnike, dhe është shndërruar në sinonim për konfliktin e pazgjidhur në pjesën veriore të Kosovës.[102] Situata është

---

[99] Beha, Adem, "Minority Rights: An Opportunity for Adjustment of Ethnic Relations in Kosovo?," *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, Vol 13, No 4, 2014, fq. 86.

[100] Djukanovic, Dragan, "The Post-conflict Integration of Minority Ethnic Communities in Kosovo," paraqitur në *Third Annual Conference on Human Security, Terrorism and Organized Crime in the Western Balkan Region*, organizuar nga projekti HUMSEC në Beograd, 2-4 tetor 2008, fq. 2.

[101] Shih "Kosovo Communities Profiles, *Organization for Security and Cooperation in Europe*, Mission in Kosovo, 2010, fq. 241; shih, po ashtu, "The Lausanne Principle: Multiethnicity, Territory and the Future of Kosovo's Serbs," *European Stability Initiative*, Berlin/Pristina, 7 qershor 2004, fq. 2.

[102] Brand, Judith dhe Idrizi, Valdete, "Grass-root Approaches to Inter-Ethnic Reconciliation in the Northern Part of Kosovo," *Kosovar Institute for Policy Research and Development*, Prishtina, shkurt 2012, fq. 4.

përkeqësuar edhe më tutje pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, meqë udhëheqësit serbë në veri kanë refuzuar rreptësisht çfarëdo qeverisje nga Kosova. Si pasojë, qarqe të ndryshme shpesh herë kanë propozuar ndarjen e veriut nga Kosova, apo "shkëmbimin territorial" me Serbinë jugore, si një modalitet për ta tejkaluar status quonë. Megjithatë, propozimet e tilla, të paktën formalisht, janë refuzuar, si nga Kosova, ashtu edhe nga Serbia. Prishtina e refuzon idenë e ndarjes, duke pohuar që kufijtë e Kosovës nuk mund të jenë çështje kompromisi, dhe që veriu, edhe pse për momentin nuk kontrollohet, mbetet pjesë integrale e territorit të saj. Edhe pse intimisht, shumë shqiptarë, edhe në Kosovë, edhe në Serbinë Jugore, do të mund të ishin të gatshëm ta pranojnë idenë e "shkëmbimit të territoreve," udhëheqësit e Kosovës janë të vetëdijshëm që një hap i tillë do ta hapte të ashtuquajturën "kuti të Pandorës," që, më pas, do t'i inkurajonte serbët në Bosnje dhe shqiptarët në Maqedoni për ta bërë të njëjtën. Nga ana tjetër, duke e pranuar ndarjen, Beogradi, në parim, do të duhej ta pranonte humbjen e pjesës tjetër të Kosovës. Për më tepër, një ndarje e tillë, apo një "shkëmbim territorial" pa dyshim që do ta fillonte spastrimin etnik të 60 përqind të serbëve të Kosovës që jetojnë në jug të Ibrit.[103]

Duhet përmendur që Kushtetuta e Kosovës i njeh 'të drejtat e diferencuara grupore' të serbëve të Kosovës si minoriteti më i madh në Kosovë. Në fakt, Neni 57.1 i Kapitullit III të Kushtetutës së Kosovës lidhur me të Drejtat e Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të tyre pohon qartë që "Banorët që i takojnë të njëjtit grup kombëtar, etnik, linguistik apo fetar, që tradicionalisht është i pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), *pos* të drejtave njerëzore dhe lirive themelore të dhëna në Kapitullin II të kësaj Kushtetute, do të kenë *të drejta të veçanta*, ashtu siç është parashtruar në këtë Kushtetutë."[104] Nga ana tjetër, propozimi i Ahtisaarit përcakton të drejta të gjera minoritare që shkojnë madje edhe përtej atyre që janë të përfshira në Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (KKMK). Për shembull, serbishtja është gjuhë zyrtare anembanë Kosovës, përfshirë hapësirat ku komuniteti serb nuk është në shumicë.[105] Pos kësaj, struktura legjislative në Kosovë është përpjekur që komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre t'u japë të drejta të avancuara të pjesëmarrjes efektive. Këto përfshijnë të drejtën për të krijuar parti politike, dhe përfaqësimin e garantuar në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në qeverisjen qëndrore, pjesëmarrja e komuniteteve është siguruar përmes përfaqësimit të garantuar në Kuvendin e Kosovës, në Qeveri, në gjyqësor dhe në trupa të tjerë. Rrjedhimisht, 20 nga 120 ulëset e Kuvendit të Kosovës janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që në Kosovë nuk janë shumicë. Komuniteti serb e ka të drejtën e minimum 10 ulëseve të garantuara (madje edhe nëse numri i ulëseve të fituara në zgjedhjet e hapura është më i vogël se 10), ndërkohë që 10 ulëse të tjera janë të garantuara për pjesëtarët e komuniteteve të tjera në vend.[106] Në nivelin lokal, në komunat ku të paktën 10 përqind e

---

[103] Për një trajtim më të hollësishëm dhe disa propozime shtesë, shih, Rossi, Michael, "Ending the impasse in Kosovo: partition, decentralization, or consociationalism?," *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity*, Vol. 42, No. 5, 2014, fq. 871.
[104] "Constitution of the Republic of Kosovo," Article 57.1, Chapter III, 15 qershor 2008, fq. 16.
[105] Shih United Nations, "Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's Future Status," S/2007/168, 26 mars 2007.
[106] 3 ulëse për komunitetin boshnjak, 2 ulëse për komunitetin turk, 1 ulëse për komunitetin goran, 1 ulëse për komunitetin rom, 1 ulëse për komunitetin ashkali, 1 ulëse për komunitetin egjiptas, dhe 1 ulëse shtesë për komunitetin rom, ashkali apo egjiptas, që e ka numrin më të madh të votave të përgjithshme.

qytetarëve të komunës u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në atë komunë, pozita e Zëvendësit të Kryesuesit për Komunitete do të rezervohet në Kuvendin Komunal për përfaqësuesin e atyre komuniteteve.[107] Duhet përmendur që plani i Ahtisaarit është implementuar në masë të madhe në jugun e Kosovës. Megjithatë, nuk është arritur ndonjë përparim në katër komunat me shumicë serbe në veri, të cilat, në parim, e refuzojnë çfarëdo qoftë bashkëpunimi me institucionet e Kosovës.

Edhe përkundrejt përparimit evident të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë të ndihmuar nga UE-ja, qeverisja dhe statusi i Veriut ende nuk janë në rendin e ditës. Kosova, Serbia dhe UE-ja, kanë vendosur që ballafaqimi me qeverisjen dhe statusin e Veriut është tejet i vështirë para se të bëhen më tepër përpjekje për të siguruar bashkëpunim në përmirësimin e zhvillimit socioekonomik të rajonit, dhe në sigurinë dhe rendin publik të tij. Megjithatë, në mesin e janarit 2013 parlamenti i Serbisë e përkrahu, dhe qeveria e Serbisë e përvetësoi, një platformë për bisedime me Prishtinën, që, në fakt, e pranon integritetin territorial dhe jurisdiksionin e Kosovës mbi Veriun. Platforma thërret për krijimin e "Bashkësisë së Pavarur të Komunave Serbe," që do të bëhet nga Veriu dhe gjashtë komuna të tjera me shumicë serbe në pjesët e tjera të Kosovës. Edhe pse një Bashkësi e tillë do të ketë fuqi të gjerë vetëqeverisëse, kjo ende do të jetë e integruar në sistemil legal të Kosovës dhe do ta zbatojë ligjin e Kosovës. Ndërkohë që platforma dhe rezoluta e Kosovës e përsërisin refuzimin tradicional të pavarësisë së Kosovës nga Serbia, është e qartë që qeveria e Serbisë është duke u përpjekur ta pranojë, dhe të punojë me realitetin *de facto*, të Kosovës sovrane, ndërkohë që është duke e lënë anash njohjen *de jure* të pavarësisë.[108] Më 19 prill 2013, me përkrahjen e Unionit Evropian, Kosova dhe Serbia e nënshkruan "Marrëveshjen e Parë për Parimet që do ta udhëheqin Normalizimin e Marrëdhënieve." Edhe pse Marrëveshja është kundërshtuar, si në Serbi, ashtu edhe në Kosovë, kjo më pas është miratuar nga parlamentet, edhe të Beogradit, edhe të Prishtinës.[109] Implementimi i suksesshëm i kësaj Marrëveshjeje mund t'i kontribuojë normalizimit, si të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, nga njëra anë, ashtu edhe të jetës së serbëve dhe të shqiptarëve në Kosovë, nga tjetra. Është e padyshimtë që normalizimi i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë do ta kishte një ndikim tepër të madh në integrimin e komunitetit serb në shoqërinë kosovare. Marrëveshja ka treguar shenja të caktuara pozitive edhe në Veri. Pasi që janë inkurajuar nga udhëheqësit në Serbi, serbët në Veri kanë marrë pjesë në një numër të madh në zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë që u mbajtën në qershor 2014. Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës, dalja e tërësishme në zgjedhje në katër komunat veriore ishte 42 përqind,

---

[107] "Political Participation," Office of the Prime-minister of the Republic of Kosovo, Office for Community Affairs; http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=2,88 (02.12.2014).

[108] Për hollësi shih, "Serbia and Kosovo: The Path to Normalisation," International Crisis Group, Europe Report N°223, 19 shkurt 2013, fq. 8-9.

[109] Marrëveshja referohet po ashtu si Marrëveshja e Brukselit. Mes tjerash, kjo specifikon që "asnjëra palë nuk do ta bllokojë, dhe nuk do t'i inkurajojë të tjerët ta bllokojnë përparimin e palës tjetër në shtigjet e tyre përkatëse për në UE." Edhe pse drafti i mëparshëm i referohej "hyrjes në organizatat ndërkombëtare," ky u refuzua nga Beogradi, meqë ky mendonte që kjo do të çonte në njohjen e tij formale të Kosovës. Shih "Information Session: First Agreement Between Serbia and Kosovo of Principles Governing Normalization of Relations," *Wilson Center*, 24 prill 2013; http://www.wilsoncenter.org/event/information-session-first-agreement-between-serbia-and-kosovo-principles-governing (17.10.2014).

fare pak më pak se dalja e tërësishme në zgjedhje në të tërë Kosovën.[110] Ndërkohë që rruga përpara është e gjatë dhe e vështirë, përmirësimi i tërësishëm i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë definitivisht mund t'i kontribuojë zbutjes së tërësishme të marrëdhënieve ndëretnike midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, dhe, përfundimisht, mund t'i kontribuojë zgjidhjeve efektive që do t'i zbusnin tendosjet në Veri.

## 6. Maqedonia

Maqedonia është e vetmja republikë e ish-Jugosllavisë që pavarësinë e vet të vitit 1991 e arriti pa ndonjë luftë në territorin e vet. Megjithatë, pavarësia e saj u vijua nga sfida vigane të jashtme dhe të brendshme. Nga aspekti i jashtëm, Shqipëria njohu, edhe shtetin, edhe kombin maqedonas, por e bëri të qartë që vullneti i saj i mirë do të varet nga statusi i minoritetit shqiptar në Maqedoni. Serbia shtetin e njohu de facto, duke e krijuar Jugosllavinë e re pa Maqedoninë, mirëpo kjo nuk e njohu ekzistencën e veçantë të Kishës Ortodokse Maqedonase. Bullgaria e njohu shtetin, por refuzoi ta pranonte që ka një komb legjitim maqedon, nga frika se mos i inkurajonte tendencat secesioniste në mesin e banorëve të Maqedonisë Bullgare, shumë nga të cilët e kishin refuzuar identitetin bullgar në favor të atij maqedonas. Për më tepër, Greqia e kundërshtoi emrin kushtetues të Maqedonisë, dhe refuzoi të pranonte që qytetarët e saj në një mënyrë legjitime mund të quheshin maqedonas.[111] Nga aspekti i brendshëm, dolën brenga serioze lidhur me karakterin e veçantë të përbërjes së saj multietnike dhe multi-konfesionale. Maqedonia është vend ku minoritetet e paraqesin një të tretën e popullatës dhe ku qytetarët kanë përkatësi të ndryshme fetare madje edhe brenda të njëjtave grupe etnike. Është e qartë, në një mjedis të tillë mund të pritet që do të ketë mjaft paragjykime shoqërore dhe kulturore.[112]

Sidoqoftë, edhe përkundrejt asaj që në një masë të konsiderueshme është etnikisht dhe fetarisht e përzier, tendosjet kryesore ndëretnike u manifestuan midis maqedonëve dhe shqiptarëve etnikë, si dy etnitë kryesore në vend. Gjatë kohës së ish-Jugosllavisë, marrëdhëniet midis këtyre dy etnive kanë qenë shumë problematike, posaçërisht pas vargut të demostratave shqiptare të vitit 1981, që e kërkonin ngritjen e statusit të Kosovës në republikë brenda federatës. Maqedonasit frikësoheshin që një republikë e tillë e propozuar e shtatë do t'i përfshinte pjesët e mbizotëruara nga shqiptarët në Maqedoninë Perëndimore, dhe do ta kufizonte për së tepërmi Republikën e Maqedonisë, dhe, sipas të gjitha gjasave, do t'i ngjallte pretendimet bullgare, dhe madje edhe ato serbe dhe greke. Kësisoj, rritja e nacionalizmit shqiptar në Maqedoni shihej si diçka mbase fatale, jo vetëm për integritetin territorial të republikës, por madje edhe për ekzistencën e kombit maqedonas.[113] Nga ana tjetër, masat e vazhdueshme të vrazhda të autoriteteve maqedonase vetëm që e ushqenin nacionalizmin

---

[110] Rettman, Andrew, "Ethnic Serbs vote as normal in Kosovo elections," EUobserver, 10 qershor 2014; http://euobserver.com/foreign/124538 (02.12.2014).
[111] Glenny, Misha, *The Fall of Yugoslavia*, botimi 3, London: Penguin Books., 1996, fq. 255.
[112] Simoska, Emilija, "Macedonia: A View on the Inter-Ethnic Relations," **Perceptions**, ***2*** (*2*), ***qershor-gusht 96***. ***Istanbul***, fq. 98.
[113] Poulton, fq. 127.

shqiptar dhe bindjen e tyre që si një grup i dallueshëm kombëtar, ngjashëm me të gjitha kombet në Jugosllavi, ata e kishin të drejtën dhe fuqinë për ta kontrolluar dhe për të vendosur vetë për fatin e tyre politik dhe kulturor. Këto procese e zgjeruan edhe më tutje hendekun midis dy komuniteteve, dhe, edhe pse bashkë-ekzistonin në të njëjtin territor, këto dyjat u bënë edhe më dyshuese ndaj njëri-tjetrit.

Megjithatë, kushtetuta e re e Republikës së Maqedonisë, përkundrazi, e uli pozitën e shqiptarëve duke e përkufizuar vendin si "shtet kombëtar të popullit maqedonas," në vend se si "shtet të popullit maqedonas dhe kombësive shqiptare dhe turke," ashtu siç kishte qenë më parë. Si pasojë, shqiptarët e bojkotuan referendumin kombëtar për pavarësi të Maqedonisë, vetëm për ta vënë në skenë referendumin e tyre jozyrtar për autonominë territoriale të Maqedonisë Perëndimore.[114] Kur një formulë e ngjashme u pranua në Preambulën e Kushtetutës së vitit 1991, elitat politike shqiptare protestuan përsëri kundër këtyre zhvillimeve dhe kërkuan që shqiptarëve që jetonin në Maqedoni t'u jipej statusi i kombit shtet-formues.[115] Për më tepër, edhe pse Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së krijuar rishtas shqiptarëve dhe kombësive të tjera u premtonte "barazi të plotë si qytetarë dhe bashkë-ekzistencë të përhershme me popullin maqedonas," pabarazitë strukturale midis grupeve etnike këmbëngulnin edhe më tutje, duke i ushqyer pakënaqësitë e shqiptarëve.[116] Pa dyshim, nga aspekti i avancimit të kërkesave politike dhe kulturore, shteti maqedonas dështoi para minoritetit të vet shqiptar. Kërkesat themelore të këtij komuniteti – përfaqësimi më i lartë, njohja e shqipes si gjuhë e dytë zyrtare, e drejta për arsimin e lartë në gjuhën shqipe, dhe autonomia administrative në nivelin qeverisës lokal – mbetën të paplotësuara edhe për rreth 10 vjet pas pavarësisë.

Rrjedhimisht, në vitin 2001 shpërtheu konflikti i armatosur midis kryengritësve etnikë shqiptarë dhe forcave qeveritare. Fatmirësisht, konflikti përfundoi shpejtë, përmes marrëveshjes së ndërmjetësuar nga UE-ja dhe SHBA-të, që u nënshkrua në gusht 2001. Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO), pos përfundimit të konfliktit të armatosur, mundësoi po ashtu një varg të masave legjislative dhe politike për ta siguruar barazinë dhe mbrojtjen e minoriteteve. Si pasojë, u bënë ndryshime kushtetuese, ndërkohë që legjislacioni ekzistues u amandamentua. Ky paket i pushtetit të decentralizuar ia dha gjuhës së minoritetit statusin e gjuhës zyrtare në zonat ku atë e flisnin të paktën 20 përqind e popullatës, përvetësoi përfaqësimin proporcional, përmirësoi edukimin në gjuhën shqipe, dhe përmirësoi pjesëmarrjen dhe punësimin e pjesëtarëve të minoriteteve në jetën publike dhe në institucionet shtetërore. Marrëveshja Kornizë e Ohrit çoi në rregullën e "shumicës së dyfishtë," që don të thotë që çfarëdo vendimesh parlamentare që i ndikonin të drejtat e komuniteteve apo vetëqeverisjen lokale, duhej të kalonin, si nga shumica e anëtarëve të parlamentit, ashtu edhe nga

---

[114] Ortakovski,Vladimir, "Interethnic Relations and Minorities in the Republic of Macedonia," *Southeast European Politics*, Vol. 2, No. 1, maj 2001, fq. 34.
[115] Ndër të tjera, anëtarët shqiptarë të parlamentit e bojkotuan votimin për kushtetutën e re: shih Daskalovski, Zhidas, "Census taking and inter-ethnic relations in Macedonia," *Southeast European and Black Sea Studies*, Vol. 13, No. 3, 365–379, 2013, fq. 369.
[116] Petroska-Beska, Violeta dhe Najcevska, Mirjana, "Macedonia: Understanding History, Preventing Future Conflict," Special Report 115, Washington DC: United States Institute of Peace, shkurt 2004, fq. 3.

shumica e numrit të votave të anëtarëve të parlamentit nga komuniteti minoritar. Në nivelin komunal janë duke u themeluar Komitetet për Marrëdhëniet Ndëretnike në zonat me mbi 20 përqind të popullatës së minoritetit; Nëse këtyre u jipet një rol domethënës, këto mund të jenë një mekanizëm i rëndësishëm për pjesëmarrje.[117] Sidoqoftë, më tepër se dhjetë vjet më vonë, marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni mbeten ende të ngarkuara nga paragjykimet dhe stereotipet, në vend se me bashkëpunim dhe përparim të dyanshëm.

Për më tepër, tendosjet etnike midis maqedonasve dhe shqiptarëve në Maqedoni janë rritur më tutje gjatë disa viteve të fundit. Të nxitura fillimisht nga incidentet e ngarkuara etnike në ndeshjet sportive, tendosjet etnike midis dy komuniteteve së shpejti u degjeneruan në dhunë, kur në shkurtin e vitit 2012 një polic maqedonas në kohën kur nuk ishte në detyre i vrau dy shqiptarë etnikë në qytetin e Gostivarit, dhe kur pesë maqedonas etnikë u vranë afër liqenit Smilkovci, në prill të vitit 2012. Që të dyja këto incidente nisën protesta masive të shqiptarëve, përkatësisht maqedonasve etnikë, duke përfunduar në dhunë dhe në dëme serioze ndaj pronave civile. Pas kësaj, ka qenë një varg sulmesh në autobusë dhe nëpër rrugë, që kishin përplasje midis të rinjve maqedonas dhe shqiptarë, dhe disa të rinj nga të dyja palët kanë pësuar lëndime serioze.[118] Situata u përkeqësua edhe më tutje kur disa shqiptarë u burgosën dhe më pas u dënuan për vrasjen në stil ekzekutimi të pesë maqedonasve etnikë. Mija shqiptarë të pakënaqur u rebeluan kundër përfundimit të gjykimit politikisht të ngarkuar për vrasje, duke e sjellur kësisoj vendin në prag të një konflikti tjetër etnik.[119]

Marrëdhëniet e tilla të sforcuara midis dy grupeve kryesore etnike janë rezultat i disa faktorëve që rëndom ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Sa për fillim, pjesa më e madhe e tendosjeve kanë rezultuar për shkak të perceptimeve të ndryshme të dy komuniteteve për konceptin themelor të shtetit maqedonas. Shqiptarët argumentonin që Maqedonia duhet të jetë shtet i qytetarëve dhe etnive të barabarta, mirëpo elitat maqedonase e preferonin një shtet etnocentrik ku ato do ta kishin pozitën mbizotëruese. Në pajtim me këtë, ashtu siç tashmë është përmendur, kushtetuta e re i favorizonte maqedonasit etnikë duke i trajtuar ata, edhe si të vetmin "komb shtetformues," edhe si "shumicë" në kuadrin e shtetit.[120] Edhe pse me ndryshimet kushtetuese që e pasuan Marrëveshjen e Ohrit preambula e Kushtetutës u ndryshua ashtu që ta pasqyronte natyrën multikulturore të shtetit, maqedonasit etnikë Maqedoninë e perceptonin edhe më tutje si shtet të tyre "të natyrshëm."[121] Argumenti i tyre kryesor rëndom shkon përgjatë pikëpamjes që shqiptarët tashmë i kanë dy shtete (Shqipërinë dhe Kosovën), kështu që, është e kuptueshme që maqedonasit do të duhej ta kishin të paktën një. Prandaj, edhe përkundrejt pretendimeve në rrjedhje e sipër të shqiptarëve për një sistem

---

[117] Për më tepër hollësi shih "Ohrid Framework Agreement," 13 gusht 2001.

[118] "Situation in Macedonia calmer but inter-ethnic tensions with Albanians linger," *The Sofia Echo*, 14 mars 2012; http://sofiaecho.com/2012/03/14/1787294_situation-in-macedonia-calmer-but-inter-ethnic-tensions-with-albanians-linger (27.10.2014).

[119] Davies, Jack, "Is Macedonia on the brink of another ethnic conflict," *Vice*, 15 korrik, 2014, http://www.vice.com/read/albanians-in-macedonia-are-pissed-off-jack-davies-777 (27.10.2014).

[120] Adamson, Kevin dhe Jovic, Dejan, "The Macedonian–Albanian political frontier: the re-articulation of post-Yugoslav political identities," *Nations and Nationalism* 10 (3), 2004, fq. 294.

[121] Slaveski, Stojan dhe Kozarev, Atanas, "'Europeanization' of the Macedonian National Identity," *The Western Balkans Policy Review*, Volume 2, Issue 1, Dimër/Pranverë 2012, Prishtinë, fq. 28.

zyrtar shtetëror dy-etnik, maqedonasit kanë qenë tejet ngurrues për të lëvizur në këtë drejtim. Rrjedhimisht, me një transformim të tillë politik të formuluar si një lojë me shumë zero të fitimit, keqperceptimi lidhur me idenë themelore të konceptit të shtetit vazhdon të jetë një shkak kryesor për tendosjet ndëretnike.

Faktori i dytë që u jep shtytje grindjeve etnike midis maqedonasve dhe shqiptarëve vjen nga perceptimet e ndryshme lidhur me pretendimet shqiptare që përftohen nga Marrëveshja e Ohrit. Ndërkohë që shqiptarët të tërë këtë proces e trajtojnë si çështje të të drejtave kolektive dhe njerëzore, maqedonasit besojnë që grindja është në fakt për territor. Për më tepër, shqiptarët marrëveshjen e shikojnë si pikënisje, si një platformë dinamike nga e cila pozita e tyre e tërësishme do të përmirësohet më tutje. Rrjedhimisht, ata Marrëveshjen e Ohrit e shohin si një pikënisje për të drejtat e tyre kolektive, në vend se si kulm të tyre.[122] Nga ana tjetër, edhe pse Marrëveshja e Ohrit e ka ruajtur karakterin unitar të vendit, maqedonasit mbeten mosbesues për synimet e vërteta të shqiptarëve, dhe dyshojnë që kërkesat e tyre për më tepër të drejta janë projekt për "Shqipërinë e Madhe" (apo për "Kosovën e Madhe").[123] Domethënë, maqedonasit etnikë kanë argumentuar që pavarësia e Kosovës e paraqet vetëm hapin e parë drejt unifikimit politik të të gjithë shqiptarëve, që do ta fillojë një efekt-domino të secesioneve të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë, të vijuar nga shqiptarët në Mal të Zi dhe në Serbinë jugore.[124] Në këtë kontekst, elitat politike maqedonase argumentojnë që shqiptarët etnikë dhe minoritetet e tjera në vend tashmë i gëzojnë të drejtat për minoritete që janë në pajtim me standardet më të larta të legjislacionit ndërkombëtar.[125] Mirëpo, shqiptarët etnikë kanë refuzuar të konsiderohen si një minoritet etnik në shtetin-komb të Maqëdonisë, dhe rrjedhimisht kanë kërkuar të drejta kolektive që shkojnë shumë mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e minoriteteve. Si pasojë, prirja e vazhdueshme e maqedonasve etnikë për të tërhequr paralele midis kërkesave shqiptare për rritjen e të drejtave kolektive në Maqedoni, dhe integritetit territorial të vendit, pa dyshim, që do t'i kontribuojë tendosjeve të mëtutjeshme midis dy komuniteteve.

Elementi përfundimtar që u ka dhënë një kontribut shtesë tendosjeve ndëretnike midis dy komuniteteve kryesore në Maqedoni është i ndërlidhur për së afërmi me integrimin euro-atlantik të vendit. Edhe pse zyrtarisht integrimi euro-atlantik ende e paraqet njërin nga prioritetet kryesore të vendit, anëtarësimi i Maqedonisë në NATO dhe në UE është ndërprerë në një mënyrë serioze gjatë viteve të fundit. Për më tepër, përkrahja e anëtarësimit në këto dy organizata e ka pësuar një rënie serioze viteve të fundit, si te politikanët maqedonas, ashtu edhe te maqedonasit etnikë përgjithësisht. Nga ana tjetër, shqiptarët etnikë në Maqedoni e përkrahin fuqishëm integrimin euro-atlantik të vendit. Ashtu siç është përmendur në disa raste nga politikanë të ndryshëm shqiptarë anembanë rajonit, Evropa, jo Shqipëria e Madhe, e paraqet shtegun e zbatueshëm drejt unifikimit të të gjithë

---

122 Aziri, Etem, "Inter-ethnic Relations in the Republic of Macedonia before and after the Ohrid Framework Agreement, *Balkans: Foreign Affairs, Politics and Socio-Cultures*, fq. 131-156. Epoka University, tetor 2011, fq. 148.
123 Fraenkel, Eran, "Macedonia," në *Nations in transit 2003*. New York: Freedom House, 2004, fq. 403.
124Batt, Judy. "Introduction," në Judy Batt, red., *Is there an Albanian question?*, Chaillot Paper No. 107, janar 2008, Institute For Security Studies, fq. 5.
125 Daskalovski, 2013, fq. 370.

shqiptarëve në Ballkan.[126] Edhe pse anëtarësimi në NATO dhe në UE është promovuar tashmë si prioritet kryesor edhe nga Unioni Demokratik për Integrim – parti shqiptare në qeverinë e koalicionit në Maqedoni – perspektivat e tilla mbeten mjaft të dobëta. Një realitet i tillë, i kombinuar me faktorët e përmendur më sipër, mund t'i kontribuojë seriozisht përkeqësimit të mëtutjeshëm të marrëdhënieve edhe ashtu të tendosura midis shqiptarëve dhe maqedonasve në vend.

## 7. Mali i Zi

Rruga e Malit të Zi drejt pavarësisë pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ka kaluar nëpër tri faza kryesore – nga Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ) (1992-2003), përmes Unionit Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi (2003-2006), e deri në Malin e Zi të pavarur (pas 2006). Kësisoj, shkallët e tilla të ndryshme të shtetësisë e kanë pasqyruar statusin e minoriteteve në marrëdhëniet e tërësishme ndëretnike në vend. Gjatë kohës së shtetit të përbashkët asimetrik me Serbinë, statusi i grupeve të ndryshme etnike që jetonin, si në Serbi, ashtu edhe në Mal të Zi, shikohej në kornizën e entitetit më të gjerë. Si pasojë, serbët dhe malazezët e kishin statusin e popujve shtet-formues, edhe pse numerikisht malazezët kanë qenë fare të vegjël. Në po këtë mënyrë, përqindja e etnive të tjera që jetonin në Mal të Zi, në parim, ishte simbolike.[127] Duhet përmendur që, edhe pse ky punim do t'i trajtojë marrëdhëniet ndëretnike pas pavarësisë së Malit të Zi, një vëmendje e caktuar do t'i jipet edhe periudhave paraprake për shkak të ndikimit të tyre në gjendjen e tashme.

Mali i Zi ia ka dalë t'i shpëtojë konflikteve etnike të armatosura të një shkalle të gjerë pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Mirëpo, faktorë të ndryshëm, të tillë si migrimi, vendosja e refugjatëve, dhe ndryshime të caktuara në identifikimin etnik, e kanë ndryshuar strukturën etnike dhe demografike të Malit të Zi gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë dhe luftrave të mëpastajme në vitet 1990.[128] Ashtu siç tashmë u shpjegua, sipas regjistrimit të fundit të mbajtur në vitin 2011, pos malazezëve (45%), tre grupet më të mëdha etnike në vend janë serbët (28.7%), boshnjakët (8.6%) dhe shqiptarët (4.9%).[129] Duke patur parasysh të kaluarën historike dhe përqindjen e tyre të lartë, ka patur debate madje edhe nëse serbët duhet të konsiderohen fare si minoritet në vend. Malazezët dhe serbët kanë qenë anëtarë në të njëjtin shtet për më tepër se 85 vjet.[130] Rrjedhimisht, vetë-identifikimi si serb apo malazez në Malin e Zi për vite të tëra ka qenë çështje e zgjedhjes personale bazuar në aspekte politike, kulturore

---

126 Shih "Topi thotë se e ardhmja e Shqipërisë është Evropa jo Shqipëria e madhe," SETimes, 14 korrik 2008; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/newsbriefs/2008/07/14/nb-05 (27.10.2014); shih, po ashtu, "Rama: Projekti ynë aktual është Evropa e Madhe, jo Shqipëria e Madhe," Agjensia e Lajmeve Sot News, 21 October 2014; http://www.sot.com.al/politike-intervista/rama-projekti-yn%C3%AB-aktual-%C3%ABsht%C3%AB-evropa-e-madhe-jo-shqip%C3%ABria-e-madhe#sthash. wfFAbb7n.dpuf (27.10.2014).

127 Pos për shqiptarët gjatë RFJ-së, meqë Kosova zyrtarisht ishte pjesë e shtetit të njëjtë.

128 Šístek, František dhe Dimitrovová, Bohdana, "National minorities in Montenegro after the break-up of Yugoslavia," në *Montenegro in Transition: Problems of Identity and Statehood*, Florian Bieber (red.), Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden, 2003, fq. 159.

129 "Population by Age and Ethnicity," Population Census in Montenegro 2011, Statistical Office of Montenegro, http://www.monstat.org/eng/page.php?id=393&pageid=57 (29.10.2014).

130 Duke filluar me Mbretërinë e Jugosllavisë në vitin 1918, dhe më pas me Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, dhe pas shpërbërjes së saj, me Republikën Federale të Jugosllavisë dhe me Unionin Shtetëror të Serbisë dhe të Malit të Zi.

dhe të tjera. Një ndarje e tillë 'etnike' në fakt ka ekzistuar madje edhe brenda familjeve të shumta në vend.[131] Sidoqoftë, serbët e sotëm zyrtarisht konsiderohen si minoritet në Mal të Zi dhe parimisht janë të shkapërderdhur anembanë territorit të vendit. Sipas regjistrimit të vitit 2011, serbët janë shumicë absolute në tri komuna, dhe janë shumicë relative në edhe tri të tjera, dhe këta paraqesin më pak se 20% të popullatës në vetëm katër nga numri i tërë i 21 komunave në vend.[132]

Përgjatë tërë historisë, malazezët, marrë në përgjithësi, kanë patur periudha të gjata të bashkëekzistencës, dhe, madje, edhe të identifikimit me serbët. Dy kombet i kanë patur të përbashkëta gjuhën dhe besimin fetar, si dhe tipare të tjera të përbashkëta të kulturave të tyre përkatëse.[133] Prandaj, studiues të shumtë kanë argumentuar që malazezët janë në parim pjesë e kombit serb që është vendosur në këtë rajon pas humbjeve në luftrat e ndryshme.[134] Mirëpo, ka shumë të tjerë që konsiderojnë që malazezët janë një komb i veçuar me një histori të ndryshme politike dhe me një ekzistencë afatgjatë të një vetëidentifikimi horizontal të dukshëm.[135] Ajo që gjithsesi është e vërtetë është që për shekuj me radhë nuk ka patur tendosje ndëretnike midis malazezëve dhe serbëve. Tendosjet e para filluan në vitin 1996 për shkak të shenjave të mospajtimit politik midis disa pjesëve të udhëheqësisë malazeze dhe të asaj serbe. Që nga atëherë, qeverisjet e njëpasnjëshme të Malit të Zi e kanë distancuar vetveten nga rendi nacionalist i ditës i Milloshevigit dhe politikave të gjenocidit. Tendosjet midis malazezëve dhe serbëve kulmuan rreth periudhës kur Mali i Zi filloi të ushtronte trysni për pavarësinë e vet dhe ndarjen nga Serbia.

Blloku "pro-pavarësisë" udhëhiqej nga Millo Gjukanoviq, Kryeministër dhe ish President i Malit të Zi, si dhe lider i Unionit Demokratik të Socialistëve (DPS). Nga ana tjetër, Predrag Bullatoviq, kreu i Partisë Popullore Socialiste (SNP) ishte lider i bllokut "unionist pro-serb." Fushata e referendumit ishte tejet e polarizuar, ku shumica e malazezëve etnikë e përkrahnin pavarësinë, ndërkohë që shumica e popullatës serbe e favorizonte vazhdimin e unionit me Serbinë. Kur në referendum pavarësia kaloi me një shumicë të sigurtë me 21 maj 2006, tendosjet midis dy komuniteteve e arritën kulmin e tyre.[136] Pas konfirmimit të pavarësisë, partitë serbe e përvetësuan një qëndrim provokues, duke refuzuar që zyrtarisht ta pranonin rezultatin e referendumit dhe duke i bojkotuar sesionet parlamentare.[137] Për më tepër, kishte kërcënime që konfliktet e ardhshme për kushtetutën, simbolet

---

131 Për një shqyrtim të hollësishëm të kësaj çështjeje, shih, për shembull, Pavlović, Srđa, "Who are Montenegrins? Statehood, identity, and civic society," në *Montenegro in Transition: Problems of Identity and Statehood*, Florian Bieber (red.), Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden, 2003, fq. 83-107.
132 Shih "Structure of population by ethnicity per municipalities in %," Population Census in Montenegro 2011, Statistical Office of Montenegro, http://www.monstat.org/eng/page.php?id=393&pageid=57 (30.10.2014).
133 Hastings, Adrian, *The Construction of Nationhood: Ethnicity, Religion and Nationalism*, Cambridge: Cambridge University Press, 1997, fq. 142.
134 See Watson, R. W. Seton, *The Rise of Nationality in the Balkans*, New York: Howard Fertig, 1966, fq. 31.
135 Tomašević, Jozo *Peasants, Politics and Economic Change in Yugoslavia,* Palo Alto: Stanford University Press, 1955, fq. 126.
136 Referendumi në fund u miratua nga 55.5% të votuesve, duke e kaluar fare pak pragun prej 55%. Shih Traynor, Ian, "Montenegro vote finally seals death of Yugoslavia," *The Guardian*, 22 maj 2006; http://www.theguardian.com/world/2006/may/22/balkans (01.11.2014).
137 "Independent Montenegro: Early Assessment and Prospects for Euro-Atlantic Integration," Committee Reports,160 CDS 07 E BIS, 2007 Annual Session of NATO Parliamentary Assembly, 2007; http://www.nato-pa.int/default.asp?SHORTCUT=1162 (02.11.2014).

shtetërore, pozitën e kishës, si dhe marrëdhëniet e qeverisë dhe opozitës, mund të çojnë në përplasje të reja.[138]

Dhe, vërtetë, që nga pavarësia, shoqëria malazeze ka qenë e ndarë rreth shumë çështjesh. Pos tendosjeve midis malazezëve dhe serbëve, roli kyç i minoriteteve të tjera që ishin pozitive ndaj referendumit të pavarësisë i ka përkeqësuar edhe më tutje marrëdhëniet ndëretnike midis serbëve dhe këtyre minoriteteve. Sidoqoftë, duke qenë të shpërndarë anembanë vendit, përfaqësuesit politikë serbë nuk janë dhënë pas kërkesave për autonomi territoriale. Në vend të kësaj, qëllimi i tyre primar ka qenë "mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe e afirmimit të plotë të identitetit dhe lirisë së popullit serb."[139] Një rend i tillë i ditës përbëhej nga disa kërkesa kryesore: (1) serbët duhet të jenë të përcaktuar me kushtetutë si një komb i veçantë dhe i barabartë (jo si një minoritet kombëtar); (2) serbët duhet të jenë të përfaqësuar në një bazë proporcionale në shtet dhe në trupat qeverisës lokalë; (3) ata duhet ta kenë të drejtën t'i paraqesin simbolet kombëtare serbe; dhe, (4) duhet të ketë konfirmim kushtetutar të serbishtes si një gjuhë zyrtare dhe i alfabetit qirilik si shkrim zyrtar.[140] Sidoqoftë, me qëlim të qetësimit të ndarjeve të brendshme politike, Kushtetuta e Malit të Zi e paraqiti "shtetin qytetar," përmes të cilit sovraniteti pushonte në "qytetarët që e kanë kombësinë malazeze." Pos kësaj, një përcaktim i tillë ishte, po ashtu, një pengesë kundër kërkesave të serbëve në Malin e Zi për t'u pranuar si popull shtetformues, që, më tutje, do të çonte në ndarjen shumëpalëshe të pushtetit.[141]

Sa i përket shfrytëzimit të gjuhëve zyrtare të minoriteteve, legjislacioni aktual është më kufizues se ish-legjislatura kombëtare dhe standardet e vendeve të tjera në rajon e tutje. Kushtetuta malazeze përcakton që gjuhë zyrtare në vend është malazezishtja me shfrytëzim të barabartë të alfabeteve qirilike dhe latine, ndërkohë që minoritetet kombëtare kanë të drejtën e shfrytëzimit zyrtar të gjuhës vetëm në nivelin lokal, në njësitë e qeverisjes lokale në të cilat minoriteti e paraqet shumicën e popullatës.[142] Edhe përkundrejt dallimeve minore midis gjuhëve malazeze dhe serbe, popullata serbe e ka kundërshtuar idenë e ndarjes linguistike të vendit.[143] Tendosje tjera midis dy komuniteteve ka patur lidhur me ndarjen e Kishës Ortodokse Malazeze nga jurisdiksioni i Kishës Ortodokse Serbe. Goditja përfundimtare nga aspekti i tendosjeve ndëretnike midis malazezëve dhe serbëve ka ardhur me njohjen zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga qeveria e Malit të Zi. Ndërkohë që Serbia e dëboi me shpejtësi ambasadorin e Podgoricës, partitë opozitare pro-serbe në Mal të Zi organizuan

---

138 Morrison, Kenneth, "Change, Continuity and Consolidation: *Assessing Five Years of Montenegro's Independence,"LSEE Papers on South Eastern Europe*, Issue 2, shkurt 2011, fq. 2.
139 "Party Program," The People's Party of Montenegro," dhjetor 2006, fq.3.
140 Morrison, 2011, fq. 6.
141 Džankić, Jelena, "Montenegro's Minorities in the Tangles of Citizenship, Participation, and Access to Rights," *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, Vol. 11, No 3, 2012, fq. 44.
142 "Minorities in Montenegro Legislation and Practice," *Report number 1, Human Rights Protection Program, Youth Initiative for Human Rights, Montenegro, 20 shkurt 2007, fq. 19.*
143 Ndarja gjuhësore e ka përfshirë krijimin e alfabetit të ri malazez qirilik, që, në parim, është alfabeti qirilik serb me shtim të dy shkronjave të reja.

demonstrata në të tërë vendin kundër vendimit qeveritar për Kosovën.[144] Megjithatë, edhe përkundrejt tensioneve evidente para dhe menjëherë pas pavarësisë, marrëdhëniet e tërësishme midis malazezëve dhe serbëve kanë qenë që atëherë pak a shumë të normalizuara.

Minoritetet e tjera, nga ana tjetër, pos që janë shumë më të vogla numerikisht, munden, po ashtu, deri në një masë, ta përcaktojnë vetveten territorialisht, meqë ato, përgjithësisht, janë të përqendruara në periferinë e republikës – shqiptarët përgjatë kufirit me Shqipërinë; shumica e boshnjakëve myslimanë përgjatë kufirit verior me Serbinë, në pjesën malazeze të rajonit të Sanxhakut; dhe kroatët në Boka Kotorska, afër kufirit me Kroacinë. Duhet përmendur që periudha midis 1992 dhe 1997 është karakterizuar me shkeljet e të drejtave themelore njerëzore, dhe posaçërisht të të drejtave të minoriteteve. Gjatë kësaj periudhe, partitë politike që i kanë përfaqësuar minoritetet ishin margjinalizuar sa i përket çështjeve politike, dhe këto ishin përjashtuar nga çfarëdo marrje e vendimeve.[145] Procesi i shkëputjes së Malit të Zi nga Serbia që nga viti 1997 kishte rezultuar në një përmirësim në raporteve shumicë-minoritet, meqë udhëheqësia malazeze përpiqej ta ndërtonte një koalicion vendës për autonomi më të madhe, dhe, përfundimisht, për pavarësi, gjë kjo që përfshirjen e minoriteteve e bënte të domosdoshme.[146] Rrjedhimisht, Ligji i vitit 2006 për të Drejtat dhe Liritë e Minoriteteve minoritetin e përcakton si "një grup të shtetasve të Malit të Zi, që janë më të pakët në numër se popullata mbizotëruese, që kanë karakteristika të përbashkëta etnike, fetare apo linguistike, të ndryshme nga pjesa tjetër e popullatës, që historikisht janë të lidhur me Malin e Zi dhe që janë të motivuar nga dëshira për ta ruajtur identitetin kombëtar, etnik, kulturor, linguistik dhe fetar." Është e qartë që ky ligj synonte që bashkësisë ndërkombëtare t'i tregonte që Mali i Zi është një shembull pozitiv i marrëdhënieve ndëretnike në Ballkan, dhe që t'i tërhiqte votat e minoriteteve që nuk ishin të krishtera ortodokse.[147] Megjithatë, pas pavarësisë, këto minoritete shpesh herë janë ndjerë të tradhëtuara nga koalicioni pro-pavarësisë.

Edhe pse nuk është aq i madh numerikisht, minoriteti shqiptar, për shkak të afërsisë së Shqipërisë dhe Kosovës, e meriton një vëmendje të veçantë sa i përket marrëdhënieve ndëretnike në Mal të Zi. Duhet përmendur që pozita e minoritetit shqiptar dhe shkalla e bashkëpunimit dhe e integrimit me shoqërinë shumicë ka qenë shumë më e madhe se në rastin e minoritetit shqiptar në Kosovë para vitit 1999, apo në Maqedoni dhe në Serbinë Jugore. Shqiptarët e Malit të Zi nuk janë përpjekur të organizojnë referendume për autonomi territoriale apo për pavarësi, ata nuk i kanë bojkotuar zgjedhjet republikane, dhe nuk ka patur përpjekje për ndonjë kryengritje të armatosur apo shenja të veprimtarive terroriste. Shqiptarët në Mal të Zi kanë qenë të shqetësuar nga zhvillimet dramatike lidhur me shqiptarët e Kosovës, dhe, deri në një masë, edhe lidhur me minoritetin shqiptar në Maqedoni. Prandaj, pas ndryshimit në orientimin politik të elitës sunduese malazeze në vitet 1997-

---

144 "Montenegro formally recognises Kosovo's independence," *SETimes*, 13 tetor 2010; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2008/10/13/feature-01 (02.11.2014).

145 Sindik, Nedeljka, "The Role of Political Parties in Minority Participation in Montenegro," në *Political Parties and Minority Participation*, Friedrich Ebert Stiftung - Office Macedonia, Skopje, 2008, fq. 182.

146 Bieber, Florian, "The instrumentalisation of Minorities in the Montenegrin Dispute over Independence," The European Centre for Minority Issues, mars 2002, fq. 3.

147 Dzankic, Jelena, "Understanding Montenegrin Citizenship," *Citizenship Studies*, 16, 3-4, 2012, fq. 343.

98, qeveria e ka dëshmuar një shkallë të rritur të bashkëpunimt dhe dialogut.[148] Mes tjerash, sipas Ligjit për Zgjedhjet të vitit 1998, nga gjitsej 78 anëtarë të parlamentit, minoritetit shqiptar i garantoheshin 5 të tillë, nga njësia elektorale në zonën ku shqiptarët janë shumicë.[149]

Megjithatë, si edhe te minoritetet e tjera në vend, pas pavarësisë, pritjet e shqiptarëve nuk u plotësuan dhe ata u zhgënjyen lidhur me të ardhmen e tyre. Pakënaqësitë e tyre burojnë nga mangësi domethënëse në shndërrimin e përkushtimeve kushtetutare të nivelit të lartë sa i përket të drejtave të minoriteteve në ligje dhe politika konkrete. Pos kësaj, shqiptarët ankohen për implementimin e ngadalshëm dhe për zbatimin anues të ligjeve ekzistuese. Kërkesat e tyre kanë të bëjnë kryesisht me procesin e rritur të decentralizimit, për shfrytëzimin më të gjerë të gjuhës shqipe, përfshirë këtu edhe edukimin universitar në gjuhën e tyre, planet mësimore në shkollat fillore dhe të mesme,[150] dhe për moszhvillimin ekonomik.[151] Edhe pse shumica e kërkesave të përfaqësuesve shqiptarë realisht mund të përmbushen nga qeveria malazeze, deri më tash masat e saj nuk i kanë përmbushur pritjet e shqiptarëve në vend. Mungesa e vendeve të punës dhe e prosperitetit në të ardhmen, ka vazhduar ta nxisë emigrimin e shqiptarëve jashtë, dhe kryesisht për në SHBA, duke e zvogëluar, kësisoj, edhe më tepër popullatën shqiptare në Mal të Zi.

## 8. Serbia

Serbia dhe serbët ishin të përfshirë në të gjitha konfliktet që e vijuan shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, pos atij në Maqedoni. Nga ana tjetër, serbët ishin kombi më i madh, dhe Serbia ishte republika më e madhe në ish-Jugosllavi. Serbia ishte e vetmja republikë që i përfshinte dy krahina autonome, atë të Kosovës dhe të Vojvodinës. Këto dy krahina autonome duhej të jipnin të drejta shtesë për shqiptarët dhe hungarezët,[152] si minoritete të mëdha etnike që ishin shkëputur nga shtetet e tyre të afërta "amë" (Shqipëria dhe Hungaria). Megjithatë, shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe luftrat që e vijuan atë, e ndryshuan në mënyrë drastike konfigurimin etnik të Serbisë. Ashtu siç tashmë është përmendur, pas mposhtjes ushtarake, disa qindra mija serbë nga Kroacia e braktisën vendin dhe u zhvendosën kryesisht në Serbi. Nga ana tjetër, pas luftës së Kosovës në vitin 1999, në Serbi u zhvendos po ashtu një numër i konsiderueshëm i serbëve, ndërkohë që numri i shqiptarëve në Republikën e Serbisë ra

[148] Šístek dhe Dimitrovová, 2003, fq. 172.
[149] Sindki, 2008, fq. 181.
[150] Cilësia e përkthimit të disa teksteve shkollore nga gjuha malazeze në shqip është shumë e dobët, dhe mungesa e teksteve shkollore për disa nga lëndët e pengon përvetësimin e plotë të njohurive. Pos kësaj, historia e shqiptarëve vështirë që mësohet fare, dhe disa teskte shkollore nuk e pasqyrojnë kulturën shqiptare në mënyrën e duhur; shih "Second Opinion on Montenegro adopted on 19 June 2013," ACFC/OP/II(2013)002, *Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities*, Council of Europe, Strasbourg, 24 shkurt 2014, fq. 29.
[151] Për një shqyrtim të hollësishëm të ankesave të shqiptarëve në Mal të Zi, shih Boga, Cafo dhe Wolff, Stefan, "Albanians in Montenegro: Waiting for Godot?," Illyria, #2067, 12-14 korrik 2011, fq. 1-7.
[152] Edhe pse krahina autonome e Vojvodinës ishte vend i rreth 25 grupeve etnike, hungarezët, që pas Luftës së Dytë Botërore përbënin 25.8 përqind ishin grupi më i madh; shih Károly Kocsis dhe Saša Kicošev, "Changing Ethnic Patterns on the Present Territory of Vojvodina," Geographical Institute, Research Centre for Astronomy and Earth Sciences of the Hungarian Academy of Sciences; http://www.mtafki.hu/konyvtar/kiadv/etnika/ethnicMAP/005_session_e.html (28.12.2014).

në mënyrë dramatike. Rrjedhimisht, marrëdhëniet e sotme ndëretnike në Serbi në një masë të madhe i pasqyrojnë këto ndryshime etnike pas vitit 1991.

Edhe pse sipas regjistrimit të fundit të mbajtur në vitin 2011, hungarezët e paraqesin minoritetin etnik më të madh në Serbi me 3.5 përqind të popullatës së vendit, rëndësia e tyre politike është zvogëluar në masë të madhe në vitet e fundit. Hungarezët kanë qenë gjithmonë të përqendruar mbi të gjithat në Vojvodinë, në të cilën sot e përbëjnë vetëm 13 përqind të popullatës, ndërkohë që serbët e paraqesin shumicën absolute me 66.76 përqind.[153] Duhet përmendur që kur në vitin 1920, bazuar në dispozitat e Traktatit të Trianonit Vojvodina u bë pjesë e Mbretërisë së Jugosllavisë, hungarezët ishin popullatë shumicë, ndërkohë që serbët paraqisnin vetëm 25.2 përqind. [154] Ndryshimet drastike të strukturës etnike të popullatës fillimisht ishin rezultat i politikave të kolonizimit të përvetësuara, edhe nga Mbretëria e Jugosllavisë, edhe nga Jugosllavia socialiste. Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, kësaj iu shtua edhe derdhja e refugjatëve serbë, nga njëra anë, dhe migrimi shumë i madh i hungarezëve në Hungari, nga tjetra. Kur, ngjashëm me Kosovën, statusi autonom i Vojvodinës u mor me dhunë në vitin 1990, Vojvodina, në përgjithësi, dhe minoriteti hungarez, në veçanti, e humbën relevancën e tyre politike. Sot, krahina ende është dëshmitare e tendosjeve dhe dhunës sporadike ndëretnike, por gjendja e tërësishme e minoriteteve etnike është më e mirë se në pjesët e tjera të vendit.[155]

Edhe përkundrejt numrave dukshëm më të vegjël, dy minoritetet më të rëndësishme në Serbi nga aspekti i tendosjeve ndëretnike janë shqiptarët dhe boshnjakët, që janë të përqendruar në Luginën e Preshevës,[156] përkatësisht në rajonin e Sanxhakut.[157] Konflikti në Luginën e Preshevës të Serbisë jugore, ku jetojnë shumica e shqiptarëve në Serbi, ka qenë drejtpërdrejtë i ndërlidhur me shfuqizimin e dhunshëm të autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. Për dallim nga Kosova, popullata shqiptare e këtushme ka organizuar parti politike që nga villimi i viteve 1990, dhe ka marrë pjesë në zgjedhjet lokale dhe kombëtare serbe që nga ajo kohë. Megjithatë, dekada të politikave diskriminuese institucionale vetëm që u bënë më të mprehta gjatë regjimit totalitar të Milloshevliqit. Rrjedhimisht, në referendumin e organizuar nga partitë politike të shqiptarëve në vitin 1992, shumica dërrmuese e shqiptarëve të Luginës së Preshevës votuan për t'iu

---

[153] Shih "Ethnicity: Data by municipalities and cities," *2011 Census of Population, Households and Dwellings in the Republic of Serbia*, Statistical Office of the Republic of Serbia, Belgrade, 2012, fq. 22.

[154] "Ethnic Hungarians in Ex-Yugoslavia," S.O.S. Transylvania – Geneva Committee, Otava, prill 1993, fq. 11.

[155] Shih Pekusic, Biljana, "Leaders call for action to halt ethnic violence in Vojvodina," *South East European Times*, 14 mars 2013; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/ features/2013/03/14/feature-04 (07.01.2015). Shih, po ashtu, Milford, Joanna, "Ethnic Tensions Reemerge In Temerin," *The Balkans Daily*, 23 tetor 2013; http://www.thebalkansdaily.com/ethnic-tensions-reemerge-in-temerin/ (07.01.2015).

[156] Lugina e Preshevës përbëhet nga komunat e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, në Serbinë jugore, dhe kjo i ka përafërsisht 120 mila katrore, dhe ndodhet në kufirin midis Serbisë dhe Kosovës. Përqindja e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë është 89.0, 54.69, përkatësisht 26.17; shih "Serbia: Maintaining Peace in the Presevo Valley," *International Crisis Group*, Europe Report N°186, 16 tetor 2007, fq. 2.

[157] Sipas regjistrimit të vitit 2011, shqiptarët paraqesin vetëm 0.08 përqind, dhe boshnjakët 2.02 përqind të të tërë popullagtës. Megjithatë, duhet përmendur që ka qenë i vërejtur një bojktotim i gjerë i regjistrimit nga shqiptarët në vend. Zakonisht, shifra e shqiptarëve në Luginën e Preshevës vlerësohet në 60,000-70,000; shih "Third Opinion on Serbia," ACFC/OPIII (2013)006, Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, 28 nëntor 2013, fq. 7. shih, po ashtu, *2011 Census of Population, Households and Dwellings in the Republic of Serbia*, 2012, fq. 22.

bashkangjitur Kosovës.[158] Referendumi nuk u njoh as nga Serbia, as nga bashkësia ndërkombëtare, dhe edhe përkundrejt shkeljeve të shpeshta të të drejtave njerëzore nga regjimi serb, të mbetura nën hijen e konfliktit të Kosovës, problemet e Luginës së Preshevës mbetën pothuaj të pavërejtura.[159]

Hyrja e trupave të NATO-s në Kosovë në qershor 1999, dhe një grumbull i ri i masave të sigurisë të imponuara në rajon nga Marrëveshja Teknike Ushtarake e hapi mundësinë për një ripërsëritje të modelit të UÇK-së në Luginën e Preshevës.[160] Rrjedhimisht, ish-ushtarët e UÇK-së nga Lugina e Preshevës e krijuan një guerile të re – Ushtrinë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB) – që e filloi konfliktin e armatosur me Serbinë. UÇPMB-ja e zbatoi të njëjtën taktikë si UÇK-ja, të "territoreve të çliruara," dhe parashtroi kërkesa zyrtare për autonominë territoriale të Luginës së Preshevës në kuadrin e Serbisë.[161] Pas shtatëmbëdhjetë muajsh të luftimeve të nivelit të ulët, përmes ndërmjetësimit të KFOR-it, më 28 nëntor 2000, u arrit marrëveshja midis autoriteteve serbe dhe UÇPMB-së për armëpushimin dhe përkushtimin e pakufizuar për zgjidhjen paqësore të konfliktit.[162] Disa ditë më vonë, më 30 nëntor 2000, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lordi Robertson, e parashtroi planin për ta ulur dhunën në rajon, që e përfshinte një paket të masave politike dhe ushtarake që do ta inkurajonte dialogun e ardhshëm.[163] Rrjedhimisht, në maj 2001, të ndihmuara nga një ndërmjetësim i fuqishëm i NATO-s, UÇPMB-ja dhe qeveria serbe e nënshkruan të ashtuquajturën "Marrëveshje të Konqulit" për përfundimin e konfliktit. Shqiptarët u zotuan se do të demobilizohen, çarmatosen dhe do ta shpërndanin UÇPMB-në, nëse u garantohej se luftëtarët e tyre do të kenë amnisti, dhe refugjatëve do t'u lejohej kthimi nëpër shtëpitë e tyre. Ata kërkuan, po ashtu, krijimin e forcës policore multi-etnike, si dhe integrimin e shqiptarëve nëpër institucionet publike. Nga ana tjetër, Zëvendës-Kryeministri i Serbisë, Nebojsha Qoviq e përpiloi një plan të hollësishëm me qëllime dhe afate kohore të përpikëta, për t'u implementuar në Luginën e Preshevës – i ashtuquajturi "Plani i Qoviqit."[164] Në fund, numri i tërësishëm i të vrarëve gjatë konfliktit ishte më i vogël se 100, ndërkohë që rreth 14,000 refugjatë e braktisën Luginën e Preshevës dhe kaluan në Kosovë.[165]

---

158 ICG Europe Report N°186, 2007, fq. 1.

159 Për një shqyrtim më të thellë të kësaj çështjeje shih "Southern Serbia: In Kosovo's Shadow," *International Crisis Group*, Europe Briefing N°43, 27 qershor 2006.

160 Marrëveshja Tekniko-Ushtarake është nënshkruar nga NATO dhe Ushtria Jugosllave më 9 qershor 1999. Ndër të tjera, kjo e përcaktonte krijimin e një zone të sigurisë pesëkilometërshe midis Kosovës dhe Serbisë; shih http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm (09.01.2015).

161 Për një shqyrtim të hollësishëm të UÇPMB-së, shih Agon Demjaha dhe Lulzim Peci, "Insurgecies in the Balkans: Albanian Liberation Armies," në Albrecht Schnabel dhe Rohan Gunaratna red. *Wars from Within: Understanding and Managing Insurgent Movements*, London: Imperial College Press, 2015.

162 Shih *Zëri Ditor*, Prishtina, 29 nëntor 2000.

163 Shih, për shembull, "NATO condemns violence in Presevo Valley," *NATO Update*, 30 nëntor 2000; http://www.nato.int/docu/update/2000/1129/eng.htm (09.01.2015).

164 Për një shqyrtim të hollësishëm shih "*Southern Serbia's Fragile Peace*," International Crisis Group, Europe Report N°152, 9 dhjetor 2003.

165 Sipas raportimeve, u vranë 10 civilë dhe u plagosën 45 të tjerë, brenda zonës së sigurisë, ndërkohë që 24 policë dhe shërbyes civilë u vranë, dhe 78 u plagosën; shih Radosław Zenderowski, Rafał Wiśniewski, "The Ethnic Conflict in the Preševo Valley: The Role of the Orthodox Religion in the Conflict," *Codrul Cosminului*, Vol. 20, No. 1, 2014, fq. 244.

Sidoqoftë, më tepër se dhjet vjetë më vonë, edhe përkundrejt investimeve të konsiderueshme infrastrukturore, shqiptarët në rajon ende ndjehen si qytetarë të rendit të dytë, dhe vazhdojnë të ankohen për pozitën e tyre të tërësishme politike dhe ekonomike në vend. Pakënaqësitë e tyre kanë të bëjnë me mungesën e mundësive të barabarta dhe të prosperimit ekonomik, papunësinë, por, po ashtu, edhe me diskriminimin, shtypjen, dhunën dhe burgosjet arbitrare.[166] Niveli i stereotipeve dhe paragjykimeve ndaj shqiptarëve është tejet i lartë dhe është duke këmbëngulur për një periudhë të gjatë, edhe përkundrejt përpjekjeve të konsiderueshme të Serbisë për të zhvilluar politika gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe integrimin e minoriteteve. Hulumtimet kanë treguar që serbët, në përgjithësi, pjesëtarët e minoriteteve etnike nuk i konsiderojnë të përshtatshëm për të mbartur pozita me përgjegjësi në shoqëri. Megjithatë, distanca më e madhe shoqërore e serbëve është e shprehur ndaj shqiptarëve, ku 60 përqind e respondentëve kanë stereotipe negative ndaj shqiptarëve, dhe 40 përqind prej tyre nuk janë të lumtur që ata i kanë si banorë të vendit të tyre.[167] Nga ana tjetër, privimi ekonomik i shqiptarëve është evident nga vrojtimi i thjeshtë i shifrave të GDP-së brenda vendit. Për shembull, në vitin 2005 per capita GDP në komunën e Medvegjës ishte 347$, në Bujanoc 571$, dhe në Preshevë 288$, krahasuar me mesataren kombëtare për Serbinë prej 2,057$.[168] Ngjashëm, modeli i diskriminimit zyrtar ekonomik është më evidenti në investimet e qeverise serbe në tri komunat. E qartë, investimet e tilla i favorizojnë zonat ku serbët janë më të shumtë: në vitin 2006, Serbia investoi në një mënyrë përmbajtësore më shumë per capita në komunën e Medvegjës, se në dy komunat e tjera me shumicë shqiptare.[169]

E qartë, pos të drejtave të shtuara për minoritetet dhe prosperitetit ekonomik, konflikti në Luginën e Preshevës është, po ashtu, konflikt për territor. Referendumi dhe rebelimi tashmë të përmendur kishin të bënin para së gjithash me pretendimet e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për t'iu bashkangjitur Kosovës. Në janar 2006, të gjithë anëtarët shqiptarë të të trija kuvendeve të Luginës së Preshevës e përvetësuan një platformë që thërriste për një shkallë të lartë të decentralizimit dhe të autonomisë territoriale për shqiptarët në Serbinë jugore, të ngjashme me ato që Beogradi i kërkonte për serbët e Kosovës. Ata e kishin përvetësuar po ashtu edhe një platformë që tri komunat e luginës duhet t'i bashkangjiten Kosovës në rast të ndarjes së Kosovës.[170] Nga ana tjetër, ashtu siç është shqyrtuar edhe më heret, kanë qenë disa propozime nga qarqet e ndryshme për shkëmbim të Luginës së Preshevës me Kosovën Veriore. Mirëpo, deri më tash propozimet e tilla, të paktën formalisht, janë refuzuar, edhe nga Kosova, edhe nga Serbia, dhe këto janë refuzuar vrullshëm, po ashtu, edhe nga bashkësia ndërkombëtare që frikësohet se një hap i tillë do ta hapë të ashtuquajturën "Kuti të Pandorës" duke i nxitur më pas edhe serbët e Bosnjes dhe shqiptarët e Maqedonisë.[171] Edhe pse gjasa që Lugina e Preshevës do t'i bashkangjitet Kosovës është tejet e vogël, kohëve të fundit e

---

[166] Shih, për shembull, Matic, Marko, "Manjine u Srbiji – meta državne represije," Aljazeera Balkans, 7 qershor 2012; http://balkans.aljazeera.net/vijesti/manjine-u-srbiji-meta-drzavne-represije (11.01.2015).
[167] Gavrilović, Daniela dhe Petrušić , Nevena, "Međunacionalni odnosi i zaštita manjinskih prava u Srbiji," *Migracijske i etničke teme*, Vol. 27, No. 3, 2011, fq. 421-422.
[168] ICG Europe Report N°186, 2007, fq. 16.
[169] Si pasojë, Presheva me 89.09 përqind të popullatës shqiptare, mori vetëm 35 përqind të investimeve të Medvegjës, ku serbët e paraqesin 68 përqind të popullatës; shih, *Ibid.*, fq. 3.
[170] ICG Europe Report N°186, 2007, fq. 10.
[171] Shih Rossi, 2014, fq. 871.

kemi patur një rikujtim të zymtë të një mundësie të tillë nga Presidenti i Partisë së Lëvizjes për Progres Demokratik (PDP) dhe prefekti i tashëm i Bujanocit, Jonuz Musliu, lidhur me ngjarjet në Krime.[172]

Ashtu siç tashmë është pohuar, minoriteti tjetër etnik që demonstron marrëdhënie ndëretnike antagoniste me shumicën serbe është ai boshnjak. Shumica e më tepër se 145,000 boshnjakëve etnikë në Serbi janë të përqendruar në rajonin e Sanxhakut.[173] Pjesa serbe e Sanxhakut përbëhet nga gjashtë komuna me popullatë të tërësishme prej 235,567 banorësh, nga të cilët 142,350 (60 përqind) janë boshnjakë myslimanë dhe 90,314 janë serbë apo malazezë ortodoksë (38 përqind).[174] Ngjashëm me shqiptarët, gjatë viteve të hershme të ish-Jugosllavisë, boshnjakët u nënshtroheshin shpesh herë masave represive nga Rankoviqi, dhe kësisoj në një mënyrë të qëndrueshme migronin në Turqi. Megjithatë, pozita e tyre u përmirësua në një masë të konsiderueshme që nga viti 1971 kur myslimaët (boshnjakët) u përkufizuan si njëri nga kombet shtet-formuese të Jugosllavisë socialiste.[175] Që nga atëherë, rajoni u karakterizua kryesisht nga një bashkëekzistencë paqësore e grupeve të ndryshme etnike dhe fetare që kryesisht e flisnin dialektin e përbashkët të gjuhës serbo-kroate. Megjithatë, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, dhe, posaçërisht gjatë dhe pas luftës në BeH, pozita e boshnjakëve në Sanxhak u përkeqësua në një masë domethënëse. Gjatë regjimit të Milloshevigit, boshnjakët iu nënshtruar gjendjes zyrtare të terrorit që përfshinte spastrim etnik të fshatrave të tëra, vrasje, kidnapime, arrestime arbitrare dhe largim nga puna.[176]

Fillimisht, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, konflikti midis minoritetit boshnjak dhe serbëve ishte një konflikt për kontrollin territorial. Nga njëra anë, nacionalistët serbë shumë shpejtë filluan t'i akuzojnë boshnjakët e Sanxhakut si tradhtarë dhe kolonë e pestë potenciale që e kërcënonin sigurinë e Serbisë dhe të Malit të Zi. Nga ana tjetër, duke e ndjerë veten të margjinalizuar dhe të kërcënuar nga një nacionalizëm i tillë agresiv serb, boshnjakë të shumtë shikonin në drejtim të Bosnjes si atdhe i tyre shpirtëror, duke e përforcuar kësisoj më tutje paranojën e nacionalistëve serbë lidhur me tendencat separatiste të boshnjakëve të Sanxhakut.[177] Rrjedhimisht, më 25-27 tetor 1991, boshnjakët e organizuan një referendum për autonominë e Sanxhakut. Dalja ishte pothuaj 70 përqind, nga të cilët 98 përqind të boshnjakëve të Sanxhakut votuan për "autonominë komplete politike dhe territoriale me të drejtën për t'iu bashkangjitur ndonjërës nga republikat."[178] Mirëpo, referendumi nuk u njoh as nga autoritetet serbe, as nga bashkësia ndërkombëtare. Në vend të kësaj, forcat e

---

172 "Serbian Minister Vulin: Albanians from Presevo Valley Threaten Serbia," Independent, The Macedonian English Language News Agency, 18 mars 2014; http://www.independent.mk/articles/2801/Serbian+Minister+Vulin+Albanians+from+Presevo+Valley+Threaten+Serbia#sthash.gcJQdho6.dpuf (10.01.2015).

173 Sanxhaku është një rajon multi-etnik prej përafërsisht 8,700 kilometrash katrorë që ndodhet në jugperëndim të Serbisë dhe në veri të Malit të Zi, që kufizohet, po ashtu, me Bosnjen e Hercegovinën në anën e vet perëndimore dhe me Kosovën në skajin e saj juglindor; shih Morrison, Kenneth, "Political and Religious Conflict in the Sandžak," Balkan Series 8/13, Advanced Research and Assessment Group, Defence Academy of the UK, prill 2008, fq. 1.

174 Gjashtë komunat janë Novi Pazari, Sjenica, Tutini, Nova Varosh, Prijepolje dhe Priboji; shih "Serbia's Sandzak: Still Forgotten," International Crisis Group, Europe Report N°162, 8 prill 2005, fq. 1.

175 Morrison, 2008, fq. 2-3.

176 ICG Europe Report N°162, 2005, fq. 10.

177 Morrison, 2008, fq. 3.

178 Biserko, Sonja, *Minorities in Serbia*, Belgrade: Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, 2000, fq. 100.

ushtrisë jugosllave dhe paramilitarët serbë dhe malazezë e filluan një fushatë të spastrimit etnik të boshnjakëve të Sanxhakut, edhe në Serbi, edhe në Mal të Zi. Ishte evidente që qëllimi ishte të hiqen popullatat "armiqësore" boshnjake që do të mund t'i ndihmonin potencialisht luftës së boshnjakëve të Bosnjes përtej kufirit, si dhe të sigurohej integriteti territorial i Sanxhakut.[179] Boshnjakëve iu dha një mesazh i qartë që çfarëdo përpjekje për secesion (apo madje edhe për autonomi më të madhe) do të shihet si një veprim i agresionit dhe gjithsesi do të përballet me forcë. Gjatë kësaj periudhe, për shkak të reprezaljeve tejet të mëdha dhe terrorit shtetëror, diku rreth 60,000 boshnjakë u detyruan të arratisen nga shtëpitë e tyre dhe të kërkojnë siguri në Turqi, Maqedoni dhe në vendet Perëndimore.[180]

Megjithatë, tendosjet e tilla i ushqyen, po ashtu, kërkesat boshnjake për pavarësi të Sanxhakut nga Serbia. Dega e formuar rishtas e Sanxhakut e SDA, e udhëhequr nga Sulejman Ugljanin, argumentonte në favor të pavarësisë, si dhe për atë që nëse BeH shkëputet nga Jugosllavia, Sanxhaku duhej të bashkohet me Bosnjen. Në mars 1992, menjëherë para njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Bosnjes, udhëheqësi i SDA e tërhoqi vërejtjen, po ashtu, që Sanxhaku mund t'i bashkangjitet Bosnjes nëse Serbia nuk i jep autonomi. Mirëpo, disa vite më vonë, pas refuzimit të përsëritur të Perëndimit të pretendimeve territoriale të boshnjakëve të Sanxhakut, SDA-ja e Sanxhakut e hoqi secesionin nga rendi i vet i ditës dhe filloi të ushtronte trysni për autonomi më të madhe politike dhe kulturore.[181] Mirëpo, niveli i tërësishëm i tendosjeve mbeti ende shumë i lartë, dhe incidentet sporadike ndëretnike vazhduan përgjatë të tërë viteve 1990. Madje edhe pas rënies së regjimit të Milloshevíqit, antagonizmi midis dy komuniteteve vazhdoi përgjatë pjesës më të madhe të viteve 2000.[182]

Fatkeqësisht, qeveritë vijuese në Serbi dështuan të ndërmarrin hapa pozitivë që do t'i zbusnin tendosjet midis dy grupeve kryesore etnike. Ngjashëm me shqiptarët e Luginës së Preshevës, boshnjakët e Sanxhakut vazhduan të përballen me privime ekonomike, nivele të larta të papunësisë dhe mungesë mundësish. Edhe pse ekonomia e dobët, niveli i ulët i standardit të jetesës, dhe qeverisja jofunksionale dhe e korruptuar janë realitet në pothuaj të gjitha komunat në Serbi, boshnjakët në Sanxhakun etnikisht të përzier dështimet e tilla i shohin si sulme të qëllimshme të shumicës sunduese serbe.[183] Të zhgënjyer nga autoritetet jofunksionale shtetërore, boshnjakët në Sanxhak i janë kthyter islamizmit si strehë. Sot, radikalizmi islamist në Sanxhak është në rritje e sipër, dhe ky i irriton më tutje marrëdhëniet e brtishta ndëretnike në rajon. Bosnja dhe Sanxhaku aktualisht mjaft shpesh shihen si qendrat kryesore të radikalizmit islamik në Ballkan.[184] Nëse autoritetet

---

[179] Për ta arritur këtë qëllim forcat serbe bënë vrasje, tortura, kidnapime, bombardime, rrahje, dhe madje edhe e detyruan dëbimin e boshnjakëve nga fshatra të tëra. Për më tepër hollësi shih ICG Europe Report N°162, 2005, fq. 10.
[180] Dimitrovova, Bodhana, "Bosniak or Muslim? Dilemma of one Nation with two Names," *Southeast European Politics*, tetor 2001, Vol.II, No.2, fq. 98.
[181] Ron, James, "Boundaries and violence: Repertoires of state action along the Bosnia/Yugoslavia divide," *Theory and Society*, No. 29, 2000, fq. 613.
[182] Morrison, 2008, fq. 7.
[183] ICG Europe Report N°162, 2005, fq. 16.
[184] Shih, për shembull, Maksimovic, Zoran, "Extremists Stir Up Tensions in Serbia's Sandzak," *Balkan Insight*, 23 shtator 2014; http://www.balkaninsight.com/en/article/extremists-stir-up-tensions-in-serbia-s-sandzak (13.01.2015). Shih, po ashtu, "Is

shtetërore në Serbi nuk angazhohen seriozisht në adresimin e pakënaqësive ekzistuese të boshnjakëve të Sanxhakut, marrëdhëniet ekzistuese të tendosura ndëretnike mund të bijnë shumë shpejt nën hijen e marrëdhënieve madje edhe më të vrazhda ndërfetare midis shumicës serbe dhe minoritetit boshnjak në vend.

Edhe pse është shtëpi e pothuaj 30 minoriteteve të ndryshme etnike, luftrat që e vijuan shpërbërjen e ish-Jugosllavisë e kanë transformuar Serbinë në një vend pothuaj homogjen (serbët e përbëjnë 83.32 përqind të popullatës së tërë). Megjithatë, edhe përkundrejt numrave të vegjël, marrëdhëniet ndëretnike midis shumicës serbe dhe minoriteteve të caktuara etnike mbeten të tendosura dhe problematike. Kur fjala është për shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe boshnjakët në Sanxhak, marrëdhëniet e tilla janë pa dyshim të ndikuara nga qëndrimi i përgjithshëm i Serbisë ndaj Kosovës dhe Bosnjes e Hercegovinës. Serbia kohëve të fundit e ka arritur një përparim të caktuar në trajtimin e minoriteteve të veta. Megjithatë, ende është një mungesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe strategjike ndaj integrimit të minoriteteve kombëtare në Serbi. Ksenofobia dhe mostoleranca fetare vazhdojnë ta karakterizojnë shoqërinë serbe, ndërkohë që personat që u takojnë minoriteteve kombëtare janë ende caqe të sulmeve raciste. Pos kësaj, minoritetet kombëtare vazhdojnë ende të jenë të nën-përfaqësuara në një mënyrë domethënëse, si në administratat publike të nivelit shtetëror, ashtu edhe në ndërmarrjet publike.[185] Është koha e fundit që Serbia të shkëputet nga e kaluara, dhe që si një vend kandidat serioz për UE të përqendrohet në atë që minoriteteve të veta t'u ofrojë të drejta dhe liri në pajtim me standardet më të larta evropiane.

## 9. Përfundime dhe Rekomandime

Shpërbërja e dhunshme e ish-Jugosllavisë ka lënë trashëgimi mosbesime dhe armiqësi të thella midis etnive shumicë dhe pakicë në shtetet e reja që u shfaqën nga ajo. Përjashtim nga kjo rregull është Shqipëria, ku marrëdhëniet ndëretnike midis shumicës shqiptare dhe minoriteteve greke, maqedonase dhe të tjera, janë relativisht të mira.

Një çështje rënduese në të gjitha vendet e rajonit, pos Malit të Zi, janë mospajtimet rreth numrit të pjesëtarëve të komuniteteve minoritare që banojnë brenda këtyre shteteve. Një tipar shtesë i minoriteteve etnike është ai i kombësisë së padeklaruar në regjistrimet kombëtare. Po ashtu, këto shtete, me përjashtim të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, kanë kaluar nëpër ndryshime dramatike të përbërjes së strukturës së tyre etnike për shkak të luftrave dhe mizorive që janë shoqëruar me probleme të njerëzve që janë shndërruar në refugjatë dhe në të zhvendosur të brendshëm.

Pos kësaj, rrëfimet për pozitat e komuniteteve të minoriteteve etnike në shtetet e rajonit, pos në Shqipëri dhe Kroaci, deri në një masë janë ende të hapura. Kroatët dhe, posaçërisht, serbët, në

---

Islamist Radicalism Rising in Serbia?," *The XX Committee*, 14 shtator 2014; http://20committee.com/2014/09/14/is-islamist-radicalism-rising-in-serbia/ (13.01.2015).
[185] "Third Opinion on Serbia," 2013, fq. 2.

Bosnje e Hercegovinë kanë ende ambicje separatiste, pavarësisht nga statusi i tyre i barabartë me boshnjakët dhe natyra federale e këtij shteti. Në Kosovë, komuniteti serb kërkon autonomi më të fuqishme territoriale, ndërkohë që ata që jetojnë në veriun e vendit janë tejet të prirur ndaj separatizmit dhe njësimit me Serbinë. Shqiptarët në Maqedoni janë të pakënaqur me pozitën e tyre, dhe janë duke kërkuar më tepër të drejta në nivelin kombëtar. Situata është pak a shumë e njëjtë me minoritetin etnik serb në Mal të Zi. Në Serbi, edhe boshnjakët në Sanxhak, edhe shqiptarët në Luginën e Preshevës janë duke kërkuar autonomi territoriale dhe janë të prirur ndaj separatizmit dhe njësimit me Bosnjen e Hercegovinën, përkatësisht Kosovën.

Marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërshtetërore në dhe midis vendeve të veçanta të Ballkanit Perëndimor janë përbërës të po të njëjtit ekuacion. Përmirësimet apo përkeqësimet e marrëdhënieve midis vendeve të veçanta të Ballkanit Perëndimor e kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet ndëretnike brenda këtyre shteteve. Pavarësisht nga marrëdhëniet e përmirësuara, mosbesimi ende mbizotëron në marrëdhëniet bilaterale midis vendeve fqinje në Ballkanin Perëndimor, kryesisht për shkak të frikës së shfrytëzimit të minoriteteve etnike nga vendet e tjera fqinje për qëllime separatiste apo destabilizuese.

## Rekomandime:

1. Qeveria e Kosovës duhet t'ia kushtojë vëmendjen e duhur situatës së marrëdhënieve ndëretnike në vendet fqinje dhe në Bosnje e Hercegovinë. Për këtë qëllim, në kuadrin e Drejtorisë për Çështjet Rajonale të Ministrisë së Punëve të Jashtmee duhet themeluar task-forcën për këtë çështje ashtu që kjo të ndiqet në mënyrë sistematike.

2. Të gjitha vendet në rajon, dhe posaçërisht Serbia në raport me Bosnjen e Hercegovinën dhe Kosovën, si dhe Kosova në raport me Luginën e Preshevës, duhet ta qartësojnë që ndryshimet e kufijve janë të papranueshëm.

3. UE-ja së bashku me OSBE-në dhe Këshillin e Evropës duhet ta ushtrojnë një trysni të posaçme në të gjitha vendet e rajonit për të organizuar regjistrime kredible, ashtu që t'i zgjidhin grindjet mbizotëruese rreth numrit të pjesëtarëve të komuniteteve etnike minoritare.

4. Unioni Evropian, OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës duhet ta fuqizojnë qasjen rajonale ndaj marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërshtetërore. Vëmendje e veçantë duhet t'i jipet Sanxhakut dhe Luginës së Preshevës që janë lënë anash fushës së marrëdhënieve ndërshtetërore midis Serbisë dhe Bosnjes e Hercegovinës, përkatësisht Serbisë dhe Kosovës.

5. OSBE-ja duhet ta merr parasysh mundësinë e hapjes së zyrave në Sanxhak dhe në Luginën e Preshevës ashtu që t'i përcjellë nga afër këto dy zona që praktikisht janë lënë pa mbrojtje.

## Bibliografia

### Books, Books' chapters, Journals


Adamson, Kevin and Jovic, Dejan, "The Macedonian–Albanian political frontier: the re-articulation of post-Yugoslav political identities", Nations and Nationalism 10 (3), 2004.

Agon Demjaha and Lulzim Peci, "Insurgecies in the Balkans: Albanian Liberation Armies", in Albrecht Schnabel and Rohan Gunaratna ed. Wars from Within: Understanding and Managing Insurgent Movements, London: Imperial College Press, 2015.

Aziri, Etem, "Inter-ethnic Relations in the Republic of Macedonia before and after the Ohrid Framework Agreement, Balkans: Foreign Affairs, Politics and Socio-Cultures.

Barjarba, Kosta, "Migration and Ethnicity in Albania: Synergies and Interdependencies", Brown Journal of World Affairs, Vol. XI, Issue 1, Summer/Fall 2004.

Batt, Judy. "Introduction" in Judy Batt eds., Is there an Albanian question?, Chaillot Paper No. 107, January 2008, Institute For Security Studies.

Beha, Adem, "Minority Rights: An Opportunity for Adjustment of Ethnic Relations in Kosovo?," Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe, Vol 13, No 4, 2014.

Burg, Steven, and Shoup, Paul, The War in Bosnia-Herzegovina: Ethnic Conflict and International Intervention, New York: M. E. Sharpe, 1999.

Calic, Marie-Janine, "Kosovo in the twentieth century: A historical account", in Ramesh Thakur and Albrecht Schnabel ed., Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship, United Nations University Press, Tokyo, December 2000.

Demjaha, Agon "Kosovo: A Perspective from Inside", in Ramesh Thakur and Albrecht Schnabel ed., Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship, United Nations University Press, Tokyo, December 2000.

Dimitrovova, Bodhana, "Bosniak or Muslim? Dilemma of one Nation with two Names", Southeast European Politics, October 2001, Vol. II, No.2.

Džankić, Jelena, "Montenegro's Minorities in the Tangles of Citizenship, Participation, and Access to Rights", Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe, Vol. 11, No 3, 2012.

Dzankic, Jelena, "Understanding Montenegrin Citizenship", Citizenship Studies, 16, 3-4, 2012.

Fraenkel, Eran, "Macedonia", in Nations in transit 2003. New York: Freedom House, 2004.

Gavrilović, Daniela and Petrušić , Nevena, "Međunacionalni odnosi i zaštita manjinskih prava u Srbiji", Migracijske i etničke teme, Vol. 27, No. 3, 2011.

Gearóid Ó Tuathail and John O'Loughlin "After Ethnic Cleansing: Return Outcomes in Bosnia-Herzegovina a Decade Beyond War", Annals of the Association of American Geographers, Vol.99, Issue 5, 2009.

Glenny, Misha, The Fall of Yugoslavia, 3rd edition, London: Penguin Books., 1996.

Hastings, Adrian, The Construction of Nationhood: Ethnicity, Religion and Nationalism, Cambridge: Cambridge University Press, 1997.

Hivzi Islami, "Demographic Reality of Kosovo", in Dusan Janjic and Shkelzen Maliqi, eds., Conflict or Dialogue: Serbian-Albanian Relations and Integration of the Balkans, Subotica: Open University, European Civic Centre for Conflict Resolution, 1994.

Hudson, Kate, Breaking the South Slav dream: the rise and fall of Yugoslavia, London: Pluto Press, 2003.

Huszka, Beáta, Secessionist movements and ethnic conflict: debate-framing and rhetoric in independence campaigns, New York: Routledge, 2014.

Kukić, Slavo, "Položaj nacionalnih i vjerskih manjina u Bosni i Hercegovini," Politička Misao, Vol. 38, br. 3, 2001.

Marko, Joseph, "Bosnia and Herzegovina - Multi-Ethnic or Multinational?", in Council of Europe (ed.), Societies in Conflict: The contribution of law and democracy to conflict resolution, Science and Technique of Democracy No. 29, Strasbourg 2000.

Morrison, Kenneth, "Change, Continuity and Consolidation: *Assessing Five Years of Montenegro's Independence",* LSEE Papers on South Eastern Europe, Issue 2, February 2011.

Ortakovski,Vladimir, "Interethnic Relations and Minorities in the Republic of Macedonia", Southeast European Politics, Vol. 2, No. 1, May 2001.

Pavlović, Srđa, "Who are Montenegrins? Statehood, identity, and civic society," in Montenegro in Transition: Problems of Identity and Statehood, Florian Bieber (ed.), Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden, 2003.

Radosław Zenderowski, Rafał Wiśniewski, "The Ethnic Conflict in the Preševo Valley: The Role of the Orthodox Religion in the Conflict," Codrul Cosminului, Vol. 20, No. 1, 2014.

Ron, James, "Boundaries and violence: Repertoires of state action along the Bosnia/Yugoslavia divide," Theory and Society, No. 29, 2000.

Rossi, Michael, "Ending the impasse in Kosovo: partition, decentralization, or consociationalism?," Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity, Vol. 42, No. 5, 2014.

Selatin, Kllokoqi, Blerim Ahmeti, Glauk Konjufca and Valon Murati, "The Role of Human and Minority Rights in the Process of Reconstruction and Reconciliation for State and Nation-Building: Kosova", Human and Minority Rights in the Life Cycle of Ethnic Conflicts, February 2008.

Simoska, Emilija, "Macedonia*: A View on the Inter-Ethnic Relations,"* Perceptions*,* 2 *(*2*),* June-August*:* 96-98, Istanbul.

Šístek, František and Dimitrovová, Bohdana, "National minorities in Montenegro after the break-up of Yugoslavia," in Montenegro in Transition: Problems of Identity and Statehood, Florian Bieber (ed.), Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden, 2003.

Slaveski, Stojan and Kozarev, Atanas, "'Europeanization' of the Macedonian National Identity," The Western Balkans Policy Review, Volume 2, Issue 1, Winter/Spring 2012, Prishtina.

Tansey, Oisín, "Kosovo: Independence and Tutelage," Journal of Democracy, Vol. 20, No. 2, April 2009.

Tatalović, Sinisa, "National Minorities and Croatian Democracy," Politička misao, Vol. XLIII, No. 5, 2006.

Tomašević, Jozo Peasants, Politics and Economic Change in Yugoslavia, Palo Alto: Stanford University Press, 1955.

Vickers, Miranda, "The Greek Minority in Albania – Current Tensions," Balkan Series 10/02, Defence Academy of the United Kingdom, 2010.

Watson, R. W. Seton, The Rise of Nationality in the Balkans, New York: Howard Fertig, 1966.

Žunec, Ozren, "Operations Flash and Storm', in Magaš and Žanić, The War in Croatia and Bosnia-Herzegovina 1991-1995, New York: Frank Cass Publishers, 2001.

**Articles, Policy Papers, Reports, Documents**

"Albania: Minority ethnic groups", Country Information and Guidance, Home Office United Kingdom, 14 November 2014.

"Albania: State of the Nation", International Crisis Group, Balkans Report N°111, 25 May 2001.

"Albania: The Greek Minority", Human Rights Watch/Helsinki, Vol. 7, No. 4, 2 February 1995.

"Bosnia: What does Republika Srpska want?", International Crisis Group, Europe Report N°214, 6 October 2011.

Brand, Judith and Idrizi, Valdete, "Grass-root Approaches to Inter-Ethnic Reconciliation in the Northern Part of Kosovo", Kosovar Institute for Policy Research and Development, Prishtina, February 2012.

"Croatia Country Report", Bertelsmann Stiftung's Transformation Index (BTI), 2014.

"Ethnic Hungarians in Ex-Yugoslavia", S.O.S. Transylvania – Geneva Committee, Ottawa, April 1993.

"Ethnicity: Data by municipalities and cities", 2011 Census of Population, Households and Dwellings in the Republic of Serbia, Statistical Office of the Republic of Serbia, Belgrade, 2012.

"Federation of Bosnia and Herzegovina – A Parallel Crisis", International Crisis Group, Europe Report N°209, 28 September 2010.

"Fourth Report of the Republic of Croatia on the Implementation of the Framework Convention for the Protection of National Minorities", ACFC/SR/IV(2014)012, Government of the Republic of Croatia, July 2014.

"Fourth Report of the Republic of Croatia on the Implementation of the Framework Convention for the Protection of National Minorities", 2014.

"Kosovo Communities Profiles", Organization for Security and Cooperation in Europe, Mission in Kosovo, 2010.

"North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice", International Crisis Group, Europe Report N° 211, 14 March 2011.

"Ohrid Framework Agreement", 13 August 2001.

"Party Program," The People's Party of Montenegro", December 2006.

"Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's Future Status", S/2007/168, 26 March 2007.

"Second Opinion on Montenegro adopted on 19 June 2013", ACFC/OP/II(2013)002, Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, Council of Europe, Strasbourg, 24 February 2014.

"Serbia and Kosovo: The Path to Normalisation", International Crisis Group, Europe Report N°223, 19 February 2013.

"Serbia: Maintaining Peace in the Presevo Valley", International Crisis Group, Europe Report N°186, 16 October 2007.

"Serbia's Sandzak: Still Forgotten", International Crisis Group, Europe Report N°162, 8 April 2005.

"Southern Serbia: In Kosovo's Shadow", International Crisis Group, Europe Briefing N°43, 27 June 2006.

"Southern Serbia's Fragile Peace", International Crisis Group, Europe Report N°152, 9 December 2003.

"The Lausanne Principle: Multi ethnicity, Territory and the Future of Kosovo's Serbs", European Stability Initiative, Berlin/Pristina, 7 June 2004.

"The Position of National Minorities in the Republic of Croatia - Legislation and Practice", Ombudsman Report, Republic of Croatia, Zagreb, April 2008.

"Third Opinion on Albania", ACFC/OP/III(2011)009, Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, 23 November 2011.

"Third Opinion on Croatia", ACFC/OP/III(2010)005, Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, 6 December 2010.

"Third Opinion on Serbia", ACFC/OPIII (2013)006, Advisory Committee on the Framework Convention for the Protection of National Minorities, 28 November 2013.

"Third report on Albania", European Commission against Racism and Intolerance, 17 December 2004.

"World Directory of Minorities and Indigenous Peoples – Albania", 2007.

2011 Census of Population, Households and Dwellings in the Republic of Serbia, 2012.

Bieber, Florian, "The instrumentalisation of Minorities in the Montenegrin Dispute over Independence", The European Centre for Minority Issues, March 2002.

Biserko, Sonja, Minorities in Serbia, Belgrade: Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, 2000.

Bjelajac, Mile and Žunec, Ozren "The War in Croatia, 1991-1995", Round table in Zagreb, Scholars Initiative report, 20 October 2007.

Boga, Cafo and Wolff, Stefan, "Albanians in Montenegro: Waiting for Godot?", Illyria, #2067, 12-14 July 2011.

Caspersen, Nina, "The Thorny Issue of Ethnic Autonomy in Croatia: Serb Leaders and Proposals for Autonomy", Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe, Issue 3, 2003.

Constitution of the Republic of Kosovo, 15 June 2008.

Constitutional Law on Human Freedoms and Rights and Rights of Ethnic and National Minorities, 2000.

Constitutional Law on the Rights of National Minorities, Official Gazette, 155/2002.

Croatian Parliament; Constitutional Act Amending the Constitutional National Minority Rights Act. Class: 011-01/10-01/50, Reg. no.: 71-05-03/1-10-2, Zagreb, 18 June 2010.

Daskalovski, Zhidas, "Census taking and inter-ethnic relations in Macedonia", Southeast European and Black Sea Studies, Vol. 13, No. 3, 365–379, 2013.

Djukanovic, Dragan, "The Post-conflict Integration of Minority Ethnic Communities in Kosovo", presented in the Third Annual Conference on Human Security, Terrorism and Organized Crime in the Western Balkan Region, organized by the HUMSEC project in Belgrade, 2-4 October 2008.

Djuric, Ivana, "Local Governance, Integration and Participation of Croatian Serbs: In search of a prosperous model", Paper delivered at the NISPAcee Annual 10th Conference "Delivering Public Services in CEE Countries, Trends and Developments," Krakow, Poland, April 2002.

ICG Europe Report N°162, 2005.

ICG Europe Report N°186, 2007.

ICG Europe Report N°209, 2010.

ICG Report N°214, 2011.

Jan Zwierzchowski and Ewa Tabeau, "The 1992-95 War in Bosnia and Herzegovina: Census-based multiple systems estimation of casualties undercount", Conference Paper for the International Research Workshop on "The Global Costs of Conflict," Berlin, 1-2 February 2010.

King, Russell and Vullnetari, Julie, "Migration and Development in Albania", Sussex Centre for Migration Research, December 2003.

Kivimäki, Timo, Kramer, Marina and Pasch, Paul "The Dynamics of Conflict in the Multi-ethnic State of Bosnia and Herzegovina", Country Conflict-Analysis Study, Sarajevo: Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), March 2012.

Law on Elections of members of Parliament; "Official Gazette of Republic of Srebia", no. 35/2000, 57/2003 – decision of CCRS, 72/2003 –oth.law, 75/2003 – correction of oth. law, 18/2004, 101/2005 – oth. law, 85/2005 – oth.law, 28/2011 – decision of CC and 36/2011".

Lulzim Peci, "Kosovo in the Security and Defense Context of the Western Balkans", KIPRED, September 2014.

Morrison, Kenneth, "Political and Religious Conflict in the Sandžak", Balkan Series 8/13, Advanced Research and Assessment Group, Defence Academy of the UK, April 2008.

Parliament of Montenegro: Law on Minority Rights and Freedoms.

Petricusic, Antonija, "Nation-Building in Croatia and the Treatment of Minorities: Rights and Wrongs", L'Europe en Formation, Journal of Studies on European Integration and Federalism, Issue 3, 2008.

Petroska-Beska, Violeta and Najcevska, Mirjana, "Macedonia: Understanding History, Preventing Future Conflict", Special Report 115, Washington DC: United States Institute of Peace, February 2004.

Pettifier, James, "The Greek Minority in Albania in the Aftermath of Communism", Conflict Studies Research Centre, July 2001.

Sindik, Nedeljka, "The Role of Political Parties in Minority Participation in Montenegro", in Political Parties and Minority Participation, Friedrich Ebert Stiftung - Office Macedonia, Skopje, 2008.

The Constitution of the Republic of Kosovo; Chapter IV - Assembly of the Republic of Kosovo, Structure of Assembly.

United Nations, "Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's Future Status", S/2007/168, 26 March 2007.

US, Russia, EU and UN representatives from the Peace Conference on the Former Yugoslavia.

Yannis, Alexandros, "The UN as Government in Kosovo", Global Governance 10, 2004.
Zëri Ditor, Prishtina, 29 November 2000.

**Web Sources**

"Bosnia Census in 2013," European Parliamentary Research Service, 27 January 2014; http://epthinktank.eu/2014/01/27/bosnia-2013-census/ (21.12.2014).

"Country Report on Human Rights Practices 2013: Albania," United States Department of State (USSD), (27 February 2014).
http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/index.htm?year= 2013&dlid=220247 (11.11.2014).

"Estimation of Kosovo Population 2012," Press Release, Kosovo Agency of Statistics, 06 March 2013; http://esk.rks-gov.net/rekos2011/?cid=2,40 (16.11.2014).

"Final census findings lead to concerns over accuracy," Tirana Times, 19 December 2011; http://www.tiranatimes.com/news.php?id=14605&cat=1 (10.11.2014).

"Final census findings lead to concerns over accuracy," Tirana Times, 19 December 2011; http://www.tiranatimes.com/news.php?id=14605&cat=1 (10.11.2014).

"Final census findings lead to concerns over accuracy," Tirana Times, 19 December 2011; http://www.tiranatimes.com/news.php?id=14605&cat=1 (10.11.2014).

"Independent Montenegro: Early Assessment and Prospects for Euro-Atlantic Integration," Committee Reports, 160 CDS 07 E BIS, 2007 Annual Session of NATO Parliamentary Assembly, 2007; http://www.nato-pa.int/default.asp?SHORTCUT=1162 (02.11.2014).

"Information Session: First Agreement Between Serbia and Kosovo of Principles Governing Normalization of Relations," Wilson Center, 24 April 2013; http://www.wilsoncenter.org/event/information-session-first-agreement-between-serbia-and-kosovo-principles-governing (17.10.2014).

"Is Islamist Radicalism Rising in Serbia?," The XX Committee, 14 September 2014; http://20committee.com/2014/09/14/is-islamist-radicalism-rising-in-serbia/ (13.01.2015).

"Military Techical Agreement", http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm (09.01.2015).

"Minorities in Montenegro Legislation and Practice," Report number 1, Human Rights Protection Program, Youth Initiative for Human Rights, Montenegro, February 20th 2007.

"Montenegro formally recognises Kosovo's independence," SETimes, 13 October 2010; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2008/10/13/feature-01 (02.11.2014).

"NATO condemns violence in Presevo Valley," NATO Update, 30 November 2000; http://www.nato.int/docu/update/2000/1129/eng.htm (09.01.2015).

"Political Participation," Office of the Prime-minister of the Republic of Kosovo, Office for Community Affairs; http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=2,88 (02.12.2014).

"Population and Houses Census," Instituti i Statistikave, Republika e Shiperise, 2011, http://www.instat.gov.al/media/178070/rezultatet_kryesore_t__censusit_t__popullsis__dhe_banesave_2011_n__shqip_ri.pdf (17.11.2014).

"Population by Age and Ethnicity," Population Census in Montenegro 2011, Statistical Office of Montenegro, http://www.monstat.org/eng/page.php?id=393&pageid=57 (29.10.2014).

"Rama: Projekti ynë aktual është Evropa e Madhe, jo Shqipëria e Madhe," Agjensia e Lajmeve Sot News, 21 October 2014; http://www.sot.com.al/politike-intervista/rama-projekti-yn%C3%AB-aktual-%C3%ABsht%C3%AB-evropa-e-madhe-jo-shqip%C3%ABria-e-madhe#sthash.wfFAbb7n.dpuf (27.10.2014).

"Serbian Minister Vulin: Albanians from Presevo Valley Threaten Serbia," Independent, The Macedonian English Language News Agency, 18 March 2014; http://www.independent.mk/articles/2801/Serbian+Minister+Vulin+Albanians+from+Presevo+Valley+Threaten+Serbia#sthash.gcJQdho6.dpuf (10.01.2015).

"Situation in Macedonia calmer but inter-ethnic tensions with Albanians linger," The Sofia Echo, 14 March 2012; http://sofiaecho.com/2012/03/14/1787294_situation-in-macedonia-calmer-but-inter-ethnic-tensions-with-albanians-linger (27.10.2014).

"Structure of population by ethnicity per municipalities in %," Population Census in Montenegro 2011, Statistical Office of Montenegro, http://www.monstat.org/eng/page.php?id=393&pageid=57 (30.10.2014).

"The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina," 21 November 1995; http://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/BA_951121_DaytonAgreement.pdf (20.12.2014).

"Topi thotë se e ardhmja e Shqipërisë është Evropa jo Shqipëria e madhe," SETimes, 14 July 2008; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/newsbriefs/2008/07/14/nb-05 (27.10.2014).

Croatian Bureau of Statistics, http://www.dzs.hr/default_e.htm (17.12.2014).

Constitution of the Republic of Croatia, 22 December 1990; http://www.refworld.org/docid/3ae6b551c.html (18.12.2014).

Davies, Jack, "Is Macedonia on the brink of another ethnic conflict," Vice, 15 July, 2014, http://www.vice.com/read/albanians-in-macedonia-are-pissed-off-jack-davies-777 (27.10.2014).

Ginnell, Luke, "Bosnia Divided," Roads & Kingdoms, 2014; http://roadsandkingdoms.com/2014/bosnia-divided/ (22.12.2014).

Hopkins, Valerie "Bosnia census results threaten power-sharing system," Global Post, 13 November 2013; http://www.globalpost.com/dispatch/news/regions/europe/131113/bosnia-census-results-threaten-power-sharing-system (21.12.2014).

Ilic, Igor, "Croatia rejects demand for referendum to restrict Cyrillic signs," Reuters, 12 August 2014,http://news.yahoo.com/croatia-rejects-demand-referendum-restrict-cyrillic-signs-160846457.html (20.12.2014).

Human Rights Watch, Croatia: Second Class Citizens - The Serbs of Croatia, 1 March 1999, p. 3; http://www.hrw.org/reports/1999/03/01/second-class-citizens (17.12.2014).

Karadaku, Linda, "Kosovo completes 2011 census without data from north," SETimes, 16 October 2012; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2012/10/16/feature-04 (20.11.2014).

Károly Kocsis and Saša Kicošev, "Changing Ethnic Patterns on the Present Territory of Vojvodina," Geographical Institute, Research Centre for Astronomy and Earth Sciences of the Hungarian Academy of Sciences; http://www.mtafki.hu/konyvtar/kiadv/etnika/ethnicMAP/005_session_e.html (28.12.2014).

Krasniqi, Gezim, "The Politics of Numbers and Identity in Albania," Citizenship in Southeast Europe, 14 March 2012; http://www.citsee.eu/blog/politics-numbers-and-identity-albania (10.11.2014).

Maksimovic, Zoran, "Extremists Stir Up Tensions in Serbia's Sandzak," Balkan Insight, 23 September 2014; http://www.balkaninsight.com/en/article/extremists-stir-up-tensions-in-serbia-s-sandzak (13.01.2015).

Matic, Marko, "Manjine u Srbiji – meta državne represije," Aljazeera Balkans, 7 June 2012; http://balkans.aljazeera.net/vijesti/manjine-u-srbiji-meta-drzavne-represije (11.01.2015).

Milford, Joanna, "Ethnic Tensions Reemerge In Temerin," The Balkans Daily, 23 October 2013; http://www.thebalkansdaily.com/ethnic-tensions-reemerge-in-temerin/ (07.01.2015).

Minority Rights Group International, World Directory of Minorities and Indigenous Peoples - Albania: Macedonians, 2008; http://www.refworld.org/ docid/49749d65b.html (15.11.2014).

Minority Rights Group International, World Directory of Minorities and Indigenous Peoples - Croatia: Overview, 2008; http://www.refworld.org/docid/4954ce1ec.html (17.12.2014).

Pavelic, Boro, "Croatia: Serbian Language Dispute Creates Discord," Balkan Insight, 26 December 2013; http://www.balkaninsight.com/en/article/croatia-serbian-language-dispute-sparks-discord (20.12.2014).

Pekusic, Biljana, "Leaders call for action to halt ethnic violence in Vojvodina," South East European Times, 14 March 2013; http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2013/03/14/feature-04 (07.01.2015).

Rachel Irwin, Dzenana Halimovic, Maja Bjelajac, Dražen Huterer and Mladen Lakić, "Bosnian Census Risks Deepening Ethnic Rifts," Institute for War & Peace Reporting, 6 December 2013; https://iwpr.net/global-voices/bosnian-census-risks-deepening-ethnic-rifts (21.12.2014).

Rettman, Andrew, "Ethnic Serbs vote as normal in Kosovo elections," EUobserver, 10 June 2014; http://euobserver.com/foreign/124538 (02.12.2014).

Traynor, Ian, "Montenegro vote finally seals death of Yugoslavia," The Guardian, 22 May 2006; http://www.theguardian.com/world/2006/may/22/balkans (01.11.2014).
Trifunovska, Snezana, "Minority Rights in Croatia." International Journal of Minority and Group Rights 6(4), 1999.

"World Directory of Minorities and Indigenous Peoples – Albania," Minority Rights Group International, 2007; http://www.refworld.org/docid/4954cdfe1a.html (04.11.2014).